

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Kualifikimin Profesional

SHËRBIME KUJDESI PËR TË MOSHUAR

Niveli IV i KSHK¹, referuar nivelit të IV të KEK²
(Bllok 4 vjeçar)

Kodi: U1-IV-25

Miratoi:

MINISTRI

1.Korniza Shqiptare e Kualifikimit

2.Korniza Europiane e Kualifikimit

Tiranë, 2025

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.**
 1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.
- III. Plani mësimor për kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**
- XI. Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar**

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK, me kohëzgjatje 4 vjeçare, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e kujdesit për të moshuar”*.

Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtijshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar” niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar.
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, Ministria përkatëse (MEKI) përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë, nisur nga kriteret e drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënës të përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë dhe të ushtrojë kompetencat profesionale, si më poshtë:

- Të zbatojë legjislacionin në fuqi për shërbimet e kujdesit për të moshuar.
- Të zbatojë ligjin në fuqi mbi të drejtat/detyrimet e të moshuarit.
- Të përfshijë të moshuarin në vendimmarrje.
- Të parandalojë rastet e abuzimit me të moshuarit.
- Të trajtojë të moshuarit me dinjitet dhe në mënyrë të barabartë.
- Të organizojë punën në shërbime kujdesi për të moshuar.
- Të menaxhojë burimet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve të kujdesit për të moshuar.
- Të hartojë dhe ruajë dokumentacion e punës.
- Të kryejë procesin e larjes, veshjes/zhveshjes për të moshuarin.
- Të zbatojë rregullat e asepsisë gjatë pastrimit, dezinfektimit, sterilizimit etj.
- Të ndërgjegjësojë të moshuarin për zbatimin e këshillave mjekësore dhe ruajtjen e higjienës personale.
- Të marrë masa parandaluese për përhapjen e sëmundjeve infektive.
- Të kryejë identifikimin e kockave dhe artikulacioneve të trupit të njeriut.
- Të kryejë identifikimin e muskujve në trupin e njeriut.
- Të kryejë identifikimin e organeve të sistemit tretës dhe respirator
- Të zbatojë rregullat në administrimin e barnave.
- Të zbatojë udhëzimet e mjekut për dozimin e duhur të barnave.
- Të monitorojë të moshuarin gjatë dhënies së barnave.
- Të bashkëpunojë me mjekë dhe dietologë në hartimin e menu-së ushqimore.
- Të plotësojë nevojat bazë për ushqim për të moshuarin.
- Të përgatisë ushqimin për të moshuarin.
- Të pastrojë dhe dezinfektojë mjetet dhe pajisjet e ushqyerjes.
- Të ruajë në kushte optimale kampionin ushqimor

- Të menaxhojë parametrat jetësorë të të moshuarit Të përkujdeset për gjendjen shëndetësore të të moshuarit.
- Të përkujdeset për të moshuar me çrregullime të frymëmarrjes dhe sëmundje kardiovaskulare.
- Të përkujdeset për të moshuar me çrregullime dhe sëmundje të aparatit gastrointestinal dhe urogenital.
- Të përkujdeset për të moshuar me çrregullime dhe sëmundje të aparatit muskuloskeletik.
- Të përkujdeset për të moshuar me çrregullime dhe sëmundje të dëgjimit, shikimit dhe neuropsikiatrike.
- Të kryejë procedurat e duhura për hapjen dhe mbylljen e një biznesi në shërbimin për të moshuar.
- Të menaxhojë përkujdesjen shëndetësore dhe ndihmën sociale në një qendër të shërbimit për të moshuar.
- Të dokumentojë dhe raportojë mbi gjendjen shëndetësore të të moshuarit.
- Të identifikojë nevojat sociale të të moshuarit.
- Të vlerësojë gjendjen psikosociale të të moshuarit.
- Të identifikojë rrjetet mbështetëse të të moshuarit.
- Të zhvillojë empatinë të të moshuarit.
- Të ofrojë mbështetje emocionale për të moshuarit.
- Të përfshijë të moshuarit në aktivitete të ndryshme.
- Të identifikojë faktorët e riskut për neglizhim dhe abuzim.
- Të hartojë kalendarin e aktiviteteve për të moshuarit për festat zyrtare/ditëlindje.
- Të organizojë aktivitete argëtuese/edukuese për të moshuarit.
- Të organizojë mjedisin e brendshëm dhe infrastrukturën e përshtatshme për të moshuarin.
- Të parashikojë rreziqet e mundshme në mjedisin fizik për të moshuarin.
- Të përshtasë mjedisin fizik me infrastrukturën e nevojshme për të moshuarin.
- Të komunikojë me familjarët, të afërmit ose miqtë për ecurinë e të moshuarit.
- Të menaxhojë konfliktet dhe pengesat gjatë komunikimit me familjarët e të moshuarit.
- Të mbështesë familjarët e të moshuarit në rast fatkeqsie.
- Të komunikojë në mënyrë etike dhe profesionale me të moshuarit/kolegët.
- Të përdorë kanale të ndryshme komunikimi në punën me të moshuarit.
- Të zbatojë parimet e punës në grup.
- Të bashkëpunojë me aktorë të tjerë.
- Të zbatojë detyra administrative dhe tregtare.
- Të zbatojë teknikat e marketingut për promovim.
- Të zhvillohet për ngritjen e kapaciteteve profesionale.
- Të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe manualët për rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës.
- Të zbatojë protokollet për trajtimin e mbetjeve spitalore ose urbane.
- Të përdor burimet për një mjedisi të qëndrueshëm.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtijshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK, me kohëzgjatje 4 vjeçare, e pajis nxënësin me diplomën e “Maturës Shtetërore Profesionale” dhe me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në qendra

rezidenciale ose ditore për të moshuar, në shërbimet komunitare të përkujdesjes, në spitale, për t'u vetëpunësuar ose, mbas një përvoje pune, për të krijuar një biznes të vogël në fushën e shërbimeve të kujdesit për të moshuar.

Përsa i përket arsimimit të mëtejshëm, nxënësi pasi fiton "Maturën Shtetërore Profesionale" ka mundësi të vazhdojë studimet e mëtejshme të nivelit universitar dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në kualifikimin profesional "Shërbime kujdesi për të moshuar", niveli IV i KSHK.

Plani mësimor për kualifikimin profesional "Shërbime kujdesi për të moshuar" Niveli IV i KSHK						
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore			
			Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	21/22 (756)/ (792)	6/7 (216)/ (252)	10/11 (360/ 396)	12/13 (384)/ (416)
1		Gjuhë shqipe	1	1	1	1
2		Letërsi	1	1	1	1
3		Gjuhë e huaj e parë	3	1	2	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)	(1)	(1)
5		Matematikë	3	1	2	2
6		Fizikë	2	-	-	1
7		Kimi	2	-	-	-
8		Biologji	1	-	-	1
9		Shkenca sociale	2	-	-	1
10		Histori	1	1	1	-
11		Gjeografi	1	-	2	-
12		Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	2	-	-	1
13		Edukim fizik, sporte, shëndet	2	1	1	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	6 (216)	13 (468)	8 (288)	9 (288)
1	L-20-387-25	Etika profesionale në shërbimet e kujdesit për të moshuar	3			
2	L-21-745-25	Bazat e anatomisë së njeriut	3			
3	L-20-746-25	Psikologjia e zhvillimit		3		
4	L-21-747-25	Edukimi shëndetësor dhe higjiena		3		
5	L-20-748-25	Përkujdesja sociale për të moshuarit		2		
6	L-21-391-25	Njohuri mbi barnat mjekësore		3		
7	L-21-749-25	Bazat e fiziologjisë së njeriut		2		
8	L-17-197-22	Bazat e sipërmarrjes			2	2
9	L-21-393-25	Njohuri mbi bazat e geriatriisë			3	
10	L-21-238-25	Gerontologji e përgjithshme			3	
11	L-21-394-25	Njohuri mbi ushqyerjen				2
12	L-17-750-25	Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i punës.				2

13	L-17-396-25	Kuadri ligjor në fushën e kujdesit për të moshuar				2
14	L-05-198-24	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm				1
C.		Module të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)	2 (72)	9 (324)	9 (324)	6 (192)
1	M-21- 244-25	Dhënia e ndihmës së parë	72			
2	M-05-2201-25	Mjedisi fizik i sigurt për të moshuarit		36		
3	M-21- 252-25	Matja e shenjave jetësore të organizmit		72		
4	M-21- 253-25	Zbatimi praktik i recetës dhe i rekomandimeve mjekësore		36		
5	M-21- 248-25	Pastrimi, dezinfektimi, sterilizimi.		72		
6	M-20-1204-25	Respektimi i etikës profesionale dhe i të drejtave të të moshuarve		36		
7	M-20-2202-25	Zhvillimi i aktiviteteve argëtuese, kulturore dhe artistike për të moshuarin		72		
8	M-20-2203-25	Procesi i ushqyerjes për të moshuarit			36	
9	M-21- 664-25	Përkujdesja në çrregullimet dhe sëmundjet e aparatit muskuloskeletik të të moshuarit			54	
10	M-21- 663-25	Përkujdesja në çrregullimet e frymëmarrjes dhe në sëmundjet kardiovaskulare të të moshuarit			72	-
11	M-21- 665-25	Përkujdesja në çrregullimet dhe sëmundjet e aparatit gastrointestinal dhe atij urogenital të të moshuarit			72	-
12	M-21- 667-25	Përkujdesja në çrregullimet dhe sëmundjet e dëgjimit, shikimit dhe ato neuropsikiatrike të të moshuarit			54	-
13	M-20-2204-25	Bashkëpunimi me familjen/të afërmit e të moshuarit			36	
14	M-17- 826-25	Hapja dhe mbyllja e një biznesi në shërbimin social-shëndetësor				64
15	M-17- 827-25	Menaxhimi i përkujdesjes shëndetësore në një qendër shërbimit social-shëndetësor				64
16	M-17-1206-25	Mirëmbajtja e qendrës së shërbimit për të moshuar dhe administrimi i dokumentacionit të saj				64
D		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	1 (36)	2 (72)	2 (72)	2 (64)
1	M-20-1209-25	Aktivizimi dhe angazhimi social i të moshuarve	36			
2	M-21-1210-25	Vlerësimi i gjëndjes social-shëndetësore të të moshuarve në nevojë.	36			
3	M-21- 251-25	Zbatimi i masave parandaluese		72		

		shëndetësore				
4	M-17-2198-25	Drejtues për një ditë		36		
5	M-21- 258-25	Kryerja e gjimnastikës shëruese		36		
6	M-21- 669-25	Përkujdesja për të moshuarin gjatë dhe pas vdekjes			36	
7	M-17-2199-25	Shoqëria e nxënësve			36	
8	M-21- 668-25	Përkujdesja për dhimbjet dhe sëmundjet tumorale të të moshuarit.			72	
9	M-20- 670-25	Mbrojtja e të drejtave të të moshuarve, parandalimi i abuzimeve dhe procesi i ankimimit				64
10	M-17- 829-25	Rekrutimi i stafit dhe menaxhimi i burimeve njerëzore				64
		Gjithsej A + B + C + D	30/31 (1080/ 1116)	30/31 1080/ 1116)	29/30 (1044/ 1080)	29/30 (928/ 960)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 10,11 dhe 12 viti shkollor ka gjithsej 36 javë mësimore.

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë për provimin e praktikës + provimet e maturës shtetërore profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 34 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimit e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli)
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është **motivimi i nxënësve**. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një

mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësve duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Metoda e simulimit* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimi (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale të kujdestarit për të moshuar në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësve nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimeve të maturës shtetërore profesionale (sipas udhëzimeve të MAS dhe MEKI).
- b) Provimit të praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të lëndëve të përgjithshme si dhe të kompetencave profesionale (njohurive, shprehjeve, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e shërbimeve të kujdesit për të moshuarit.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me diplomën e maturës shtetërore profesionale, si edhe me certifikatën e aftësimit profesional në këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MEKI, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
 - rezultatet e provimeve përfundimtare të Nivelit IV të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Etika profesionale në shërbimet e kujdesit për të moshuar” (L-20-387-25), kl.10 - 108 orë

• Synimet e lëndës “Etika profesionale në shërbimet e kujdesit për të moshuar”, kl.10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Etika profesionale në shërbimet e kujdesit për të moshuar”, kl. 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajë parimet e Kodit të Etikës;
- Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit efektiv gjatë punës;
- Të listojë kanalet e komunikimit dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të përshkruajë parimet e komunikimit ndër personal dhe ndër institucional;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK si formë komunikimi;
- Të shpjegojë rëndësinë e motivimit të stafit;
- Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me kolegë, eprorë etj, gjatë punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
- Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes së intonacionit të zërit në komunikim;
- Të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit aktiv;
- Të shpjegojë parimet e punës në grup;
- Të argumentojë rëndësinë e mospërfshirjes ndërpersonale në raport me të moshuarin;
- Të analizojë rëndësinë e ruajtjes dhe përdorimit të të dhënave mbi të moshuarin.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Etika profesionale në shërbimet e kujdesit për të moshuar” kl.10 -108 orë

Tema 1	Parimet e Kodit të Etikës	4 orë
Tema 2	Parimet etike në vendimmarrjen për kujdesin e të moshuarve	4 orë
Tema 3	Rëndësia e komunikimit efektiv gjatë punës	9 orë
Tema 4	Kanalet e komunikimit dhe përdorimi i tyre	7 orë
Tema 5	Rëndësia e përdorimit të terminologjisë profesionale	6 orë
Tema 6	Rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal	5 orë
Tema 7	Parimet e komunikimit ndër personal dhe ndër institucional	10 orë
Tema 8	Përdorimi i TIK si formë komunikimi	9 orë
Tema 9	Rëndësia e bashkëpunimit me kolegë, eprorë etj, gjatë punës	7 orë
Tema 10	Rëndësia e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.	5 orë
Tema 11	Roli i etikës në respektimin e dinjitetit të të moshuarve	10 orë
Tema 12	Parimet e punës në grup	10 orë
Tema 13	Rëndësia e mospërfshirjes ndërpersonale në raport me të moshuar	10 orë
Tema 14	Rëndësia e ruajtjes dhe përdorimit të të dhënave mbi të moshuarin	6 orë
Tema 15	Komunikimi dhe bashkëpunimi me familjarët, të afërmit ose miqtë e të moshuarit	3 orë
Tema 16	Mënyrat e ndërmjetësimit dhe menaxhimit të konflikteve	3 orë

2. Lënda “Bazat e anatomisë së njeriut” (L-21-745-25). Kl. 10 –108 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e anatomisë së njeriut”, kl. 10

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e anatomisë së njeriut”, kl.10, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë objektin e studimit të anatomisë.
- Të përshkruajnë ndërtimin e qelizës
- Të përshkruajnë sistemin kockor.
- Të listojnë elementët e artikulacioneve.
- Të tregojnë përbërjen e muskujve.
- Të listojnë organet që përbëjnë sistemin tretës.
- Të rendisin organet që përbëjnë sistemin respirator.
- Të përshkruajnë ndërtimin e sistemit urinar.
- Të shpjegojnë ndërtimin e sistemit kardio-vaskular.
- Të identifikojnë përbërjen e sistemit nervor.
- Të listojnë gjëndrat e sistemit endokrin.
- Të tregojnë përbërjen e sistemit të shqisave.
- Të përshkruajnë përbërjen e lëkurës.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e anatomisë së njeriut”, kl. 10-108 orë

Tema 1	Hyrje në anatominë e njeriut	6 orë
Tema 2	Ndërtimi i qelizave	6 orë
Tema 3	Sistemi kockor	10 orë
Tema 4	Sistemi artikular	8 orë
Tema 5	Sistemi muskular	10 orë
Tema 6	Sistemi tretës (digjektiv)	10 orë
Tema 7	Sistemi respirator	10 orë
Tema 8	Sistemi urinar	8 orë
Tema 9	Sistemi kardio-vaskular	10 orë
Tema 10	Sistemi nervor	10 orë
Tema 11	Sistemi endokrin	8 orë
Tema 12	Organet e shqisave	8 orë
Tema 13	Lëkura dhe strukturat e lidhura me të	4 orë

3. Lënda “Psikologjia e zhvillimit ” (L-20-746-25), kl. 11 -108 orë

• Synimet e lëndës “Psikologjia e zhvillimit”, kl. 11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Psikologjia e zhvillimit”, klasa 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë proceset psikologjike të plakjes.
- Të përshkruajnë krizat psikologjike dhe përballimin e plakjes.
- Të shpjegojnë rëndësinë e mbështetjes emocionale dhe sociale për shëndetin psikologjik të të moshuarve.
- Të shpjegojnë rëndësinë e vetëvlerësimit në moshën e tretë.
- Të përshkruajnë strategjitë për promovimin e shëndetit mendor të të moshuarit.
- Të shpjegojnë proceset kognitive gjatë plakjes.
- Të shpjegojnë rëndësinë e qëndrueshmërisë psikologjike tek të moshuarit.

- Të përshkruajnë depresionin dhe ankthin tek të moshuarit.
- Të shpjegojnë ndryshimet në personalitet gjatë procesit të plakjes.
- Të shpjegojnë konceptin moshim aktiv.
- Të shpjegojnë rolin e aktiviteteve sociale dhe rekreative në përmirësimin e shëndetit psikologjik të të moshuarit.
- Të shpjegojnë pasojat psikologjike të vetmisë dhe izolimit social te i moshuari.
- Të shpjegojnë sëmundjet tipike të moshës së rritur të vonë.
- Të përshkruajnë mbështetjen që ofrohet për individët me sëmundje paliative/terminale..

Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Psikologjia e zhvillimit”, kl.11-108 orë

Tema 1	Proceset psikologjike të plakjes	6 orë
Tema 2	Krizat psikologjike dhe përballimi i plakjes	10 orë
Tema 3	Rëndësia e mbështetjes emocionale dhe sociale për shëndetin psikologjik të të moshuarve	10 orë
Tema 4	Vetëvlerësimi në moshën e tretë	8 orë
Tema 5	Strategjitë për promovimin e shëndetit mendor tek të moshuarit	6 orë
Tema 6	Proceset kognitive gjatë plakjes	8 orë
Tema 7	Qëndrueshmëria psikologjike tek të moshuarit	6 orë
Tema 8	Depresioni dhe ankthi tek të moshuarit	8 orë
Tema 9	Ndryshimet në personalitet gjatë procesit të plakjes	8 orë
Tema 10	Moshimi aktiv	8 orë
Tema 11	Roli i aktiviteteve sociale dhe rekreative në përmirësimin e shëndetit psikologjik të të moshuarit	8 orë
Tema 12	Pasojat psikologjike të vetmisë dhe izolimit social te i moshuari	8 orë
Tema 13	Sëmundjet tipike të moshës së rritur të vonë	10 orë
Tema 14	Përballja me vdekjen	4 orë

4. Lënda “Edukimi shëndetësor dhe higjiena” (L-21-747-25). Kl. 11 -108 orë

• Synimet e lëndës “Edukimi shëndetësor dhe higjiena”, kl. 11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Edukimi shëndetësor dhe higjiena”, klasa 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë konceptin higjienë dhe rëndësinë e saj.
- Të listojnë standardet e higjienës.
- Të shpjegojnë shëndetin dhe modelet e tij.
- Të përshkruajnë sëmundjet dhe stadet e saj.
- Të listojnë problematikat shëndetësore sipas grupmoshave.
- Të shpjegojnë parametrat jetësorë të individit.
- Të përshkruajnë mënyrat e ofrimit të ndihmë së parë.
- Të përshkruajnë metodat për kryerjen e përkujdesjes trupore tek individët në nevojë;
- Të shpjegojnë nevojat fiziologjike.
- Të përshkruajnë mënyrat e kontaminimit dhe masat parandaluese.
- Të shpjegojnë pastrimin, dezinfektimin dhe sterilizimin.
- Të përshkruajnë patologjitë kronike të shëndetit.
- Të identifikojnë sëmundjet infektive dhe rrugët e trasmetimit të infeksionit.
- Të përshkruajnë mjetet ndihmëse dhe përdorimin e tyre, në punën me individët në nevojë.
- Të përshkruajnë faktorët ndikues në ndotjen e ambientit.

- Të përshkruajnë masat për parandalimin e ndotjes së ambientit.
- Të përshkruaj format e ndërgjegjësimit të moshuarve për respektimin e këshillave të mjekut.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Edukimi shëndetësor dhe higjiena”, kl. 11-108 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi higjienën	6 orë
Tema 2	Standardet e higjienës	6 orë
Tema 3	Shëndeti dhe modelet e tij	6 orë
Tema 4	Sëmundja dhe stadet e saj	6 orë
Tema 5	Problematikat shëndetësore sipas grupmoshave	8 orë
Tema 6	Parametrat jetësore të organizmit	6 orë
Tema 7	Asepsia dhe rregullat aseptike	8 orë
Tema 8	Përkujdesja trupore tek individët në nevojë	8 orë
Tema 9	Nevojat fiziologjike të individit	8 orë
Tema 10	Mënyrat e kontaminimit dhe masat parandaluese	6 orë
Tema 11	Pastrimi, dezinfektimi dhe sterilizimi	10 orë
Tema 12	Njohuritë bazë mbi patologjitë kronike të shëndetit	5 orë
Tema 13	Sëmundjet infektive dhe rrugët e trasmetimit të tyre	8 orë
Tema 14	Përdorimi i mjeteve ndihmëse, në punën me individët në nevojë	6 orë
Tema 15	Faktorët ndikues në ndotjen e ambientit	5 orë
Tema 16	Ndërgjegjësimi i të moshuarve për respektimin e këshillave nga mjeku	6 orë

5. Lënda “Përkujdesja sociale për të moshuarit” (L-20-748-25) kl. 11 -72 orë

• **Synimet e lëndës “Përkujdesja sociale për të moshuarit”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri mbi bazat e ndërhyrjes sociale”, kl. 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë e marrëdhënies së besimit me të moshuarit.
- Të përshkruajnë mënyrat e shprehjeve të të dëgjuarit aktiv në punën me të moshuarit.
- Të përshkruajnë rëndësinë e identifikimit të nevojave sociale të të moshuarit.
- Të përshkruajnë mënyrat e identifikimit të pikave të forta/të dobëta të të moshuarit.
- Të përshkruajnë faktorët që ndikojnë në izolimin social, vetminë, gjendjen emocionale të të moshuarit.
- Të përshkruajnë rëndësinë e vlerësimit të gjendjes psiko-sociale të të moshuarit, përmes vëzhgimeve dhe bisedave.
- Të përshkruajnë kuptimin e rrjeteve mbështetëse në punën me të moshuarit dhe rëndësinë e tyre.
- Të përshkruajnë rëndësinë e zhvillimit të empatisë të të moshuarit.
- Të përshkruajnë rëndësinë e respektimit të vendimeve dhe zgjedhjeve të të moshuarit.
- Të shpjegojnë mënyrat e ofrimi të mbështetjes emocionale të të moshuarit.
- Të përshkruajnë rëndësinë e inkurajimit të të moshuarit për të shprehur ndjenjat dhe emocionet e tyre.
- Të përshkruajnë rëndësinë e përfshirjes sociale të të moshuarit.
- Të listojbë faktorët e riskut për neglizhim, abuzim etj.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Përkujdesja sociale për të moshuarit”, kl. 11-72 orë**

Tema 1	Rëndësia e marrëdhënies së besimit me të moshuarit	4 orë
Tema 2	Mënyrat e shprehive të të dëgjuarit aktiv në punën me të moshuarit	6 orë
Tema 3	Identifikimi i nevojave sociale të të moshuarit	6 orë
Tema 4	Mënyrat e identifikimit të pikave të forta/të dobëta të të moshuarit	6 orë
Tema 5	Faktorët që ndikojnë në izolimin social, vetminë, gjendjen emocionale të të moshuarit	6 orë
Tema 6	Rëndësia e vlerësimit të gjendjes psiko-sociale të të moshuarit	6 orë
Tema 7	Rrjetet mbështetëse në punën me të moshuarit	6 orë
Tema 8	Zhvillimi i empatisë të të moshuarit	5 orë
Tema 9	Rëndësia e respektimit të vendimeve dhe zgjedhjeve të të moshuarit	5 orë
Tema 10	Mënyrat e ofrimit të mbështetjes emocionale të të moshuarit	6 orë
Tema 11	Rëndësia e inkurajimit të të moshuarit për të shprehur ndjenjat dhe emocionet e tyre	6 orë
Tema 12	Përfshirja sociale e të moshuarit	6 orë
Tema 13	Faktorët e riskut për neglizhim dhe abuzim	4 orë

6. Lënda “Njohuri mbi barnat mjekësore” (L-21-391-25), kl. 11- 108 orë

• **Synimet e lëndës “Njohuri mbi barnat mjekësore”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri mbi barnat mjekësore” kl. 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e farmakologjisë.
- Të listojnë format farmaceutike të barnave.
- Të përshkruajnë konceptin e dozimit të barnave.
- Të listojnë rregullat e kujdesit në përdorimin e barnave.
- Të shpjegojnë rrugët e marrjes së barnave.
- Të shpjegojnë rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të mjekut në dhënien e medikamenteve.
- Të shpjegojnë procedurat e monitorimit në dhënien e medikamenteve.
- Të shpjegojnë faktorët që ndikojnë në efektin e barit.
- Të listojnë barnat me efekt në qarkullimin e gjakut dhe në zemër.
- Të listojnë barnat me efekt në traktin e frymëmarrjes.
- Të listojnë barnat me efekt në traktin tretës.
- Të listojnë barnat me efekt tek syri dhe veshi.
- Të listojnë barnat me efekt tek sistemi nervor.
- Të listojnë barnat me efekt në sistemin hematologjik.
- Të listojnë barnat kundër dhimbjes.
- Të përshkruajnë farmakologjinë e sistemit endokrin.
- Të përshkruajnë kimoterapinë.
- Të përshkruajnë alergjinë medikamentoze dhe efektet e padëshiruara.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri mbi barnat mjekësore”, kl. 11-108 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi barnat	3 orë
Tema 2	Format farmaceutike të barnave	5 orë
Tema 3	Dozimi i barnave	4 orë
Tema 4	Rregullat e kujdesit në përdorimin e barnave	5 orë
Tema 5	Rrugët e marrjes së barnave	6 orë
Tema 6	Rëndësia e zbatimit të rekomandimeve të mjekut në dhënien e	4 orë

	medikamenteve	
Tema 7	Procedurat e monitorimit në dhënien e medikamenteve	6 orë
Tema 8	Faktorët që ndikojnë në efektin e barit	5 orë
Tema 9	Barnat me efekt në gjarkullimin e gjakut dhe zemër	10 orë
Tema 10	Barnat me efekt në traktin e frymëmarrjes	8 orë
Tema 11	Barnat me efekt në traktin tretës	6 orë
Tema 12	Barnat me efekt tek syri dhe veshi	10 orë
Tema 13	Barnat me efekt tek sistemi nervor	8 orë
Tema 14	Barnat me efekt në sistemin hematologjik	6 orë
Tema 15	Barnat kundër dhimbjes	6 orë
Tema 16	Farmakologjia e sistemit endokrin	6 orë
Tema 17	Kimoterapia	4 orë
Tema 18	Alergjia medikamentoze dhe efektet e padëshiruara	6 orë

7. Lënda “Bazat e fiziologjisë së njeriut ” (L-21-749-25). Kl. 11 - 72 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e fiziologjisë së njeriut”, kl. 11 - 72 orë

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e fiziologjisë së njeriut”, kl.11, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë objektin e studimit të fiziologjisë.
- Të shpjegojnë funksionin e qelizës.
- Të përshkruajnë fiziologjinë e gjakut
- Të përshkruajnë funksionin e sistemit nervor.
- Të përshkruajnë funksionin e sistemit të pamjes.
- Të shpjegojnë funksionin e organit të dëgjimit dhe ekuilibrit
- Të përshkruajnë funksionin e muskujve.
- Të përshkruajnë funksionin e sistemit kardio-vaskular.
- Të shpjegojnë funksionin e sistemit respirator.
- Të përshkruajnë funksionin e sistemit tretës.
- Të tregojnë funksionin e sistemit endokrin
- Të shpjegojnë funksionin e sistemit renal.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e fiziologjisë së njeriut”, kl. 11 - 72 orë

Tema 1	Hyrje në fiziologji	4 orë
Tema 2	Qeliza dhe funksionet saj	4 orë
Tema 3	Gjaku dhe funksionet e tij	7 orë
Tema 4	Funksioni i sistemit nervor	6 orë
Tema 5	Sistemi i pamjes	4 orë
Tema 6	Funksioni i organit të dëgjimit dhe ekuilibrit	4 orë
Tema 7	Funksioni i muskujve	8 orë
Tema 8	Zemra dhe qarkullimi i gjakut	10 orë
Tema 9	Funksioni i sistemit respirator	6 orë
Tema 10	Funksioni i sistemit tretës	8 orë
Tema 11	Funksioni i sistemit endokrin	6 orë
Tema 12	Veshka dhe kontrolli i lëngjeve të trupit, elektroliteve e balancës acido-bazike	5 orë

8. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-22). Kl. 12 – 72 orë dhe kl. 13 – 64 orë

• **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror;
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve;
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse;
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhshme;
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to;
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme;
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore;
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup;
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore;
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore;
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.;
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme;
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit digjital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes;
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale;
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre;
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.;
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve;
- të përshkruajnë mërrdhëniet e punës në një sipërmarrje.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 72 orë**

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetëvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	4 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	4 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësi individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi digjital dhe mediat sociale	5 orë

Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	5 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë
Tema 19	Vizitë studimore në një sipërmarrje të suksesshme	4 orë

• **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve;
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit;
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi;
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit;
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi;
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi;
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi;
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi;
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi;
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes;
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve;
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet;
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
Tema 2	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
Tema 3	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
Tema 4	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
Tema 5	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
Tema 6	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
Tema 7	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
Tema 8	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
Tema 9	Buxhetimi në biznes	4 orë
Tema 10	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
Tema 11	E – sipërmarrja	2 orë
Tema 12	Veprimet individuale me bankat	3 orë
Tema 13	Siguracionet personale	3 orë

• **Synimet e lëndës “Njohuri mbi bazat geriatrike”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri mbi bazat e geriatrike”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë objektin dhe qëllimin e lëndës së geriatrike.
- Të përshkruajë etapat e plotësimit të dokumentacionit të ecurisë shëndetësore të të moshuarit.
- Të shpjegojë rëndësinë e infomimit në kohë për gjendjen aktuale shëndetësore të të moshuarit.
- Të shpjegojë normën e parametrave jetësorë të të moshuarit.
- Të shpjegojnë gjumin dhe pagjumësinë.
- Të analizojnë aftësinë e komunikimit.
- Të shpjegojnë ndryshimet dhe sëmundjet neuropsikiatrike.
- Të shpjegojnë sëmundjet kardiovaskulare.
- Të shpjegojnë sëmundjet e mushkërive dhe rrugëve të frymëmarrjes.
- Të shpjegojnë sëmundjet e aparatit muskuloskeletik.
- Të shpjegojnë sëmundjet e aparatit të tretjes.
- Të shpjegojnë sëmundjet hormonale.
- Të shpjegojnë sëmundjet e aparatit urogenital.
- Të shpjegojnë sëmundjet e lëkurës.
- Të shpjegojnë sëmundjet endokrine.
- Të shpjegojnë sëmundjet e syrit dhe veshit.
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes dhe instalimit të një aparati aerosol.
- Të shpjegojë hapat që duhet të ndërmerren për përgatitjen, ruajtjen dhe sigurimin e një të moshuari gjatë një vizite mjekësore, analize apo ndërhyrje kirurgjikale.
- Të shpjegojë rëndësinë e kujdesit paliativ.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri mbi bazat geriatrike”, kl. 12- 108 orë:**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për geriatrikë	3 orë
Tema 2	Etapat e plotësimit të dokumentacionit të ecurisë shëndetësore të të moshuarit	4 orë
Tema 3	Rëndësia e infomimit në kohë për gjendjen aktuale shëndetësore të të moshuarit;	4 orë
Tema 4	Ruajtja në normë e funksioneve vitale	6 orë
Tema 5	Sensibilizimi i të moshuarve mbi mënyrën e jetesës dhe ushqyerjen	4 orë
Tema 6	Gjumi dhe pagjumësia. Aftësia komunikuese.	6 orë
Tema 7	Ndryshimet dhe sëmundjet neuropsikiatrike.	7 orë
Tema 8	Sëmundjet kardiovaskulare	10 orë
Tema 9	Sëmundjet e mushkërive dhe rrugëve të frymëmarrjes	10 orë
Tema 10	Sëmundjet e aparatit muskuloskeletik	6 orë
Tema 11	Sëmundjet e aparatit të tretjes	6 orë
Tema 12	Sëmundjet hormonale	7 orë
Tema 13	Sëmundjet e aparatit urogenital	8 orë
Tema 15	Sëmundjet e lëkurës	6 orë
Tema 16	Sëmundjet endokrine	7 orë
Tema 17	Sëmundjet e syrit dhe veshit	6 orë
Tema 18	Mënyra e përgatitjes dhe instalimit të një aparati aerosol	3 orë
Tema 19	Hapat për përgatitjen, ruajtjen dhe sigurimin e një të moshuari gjatë ekzaminimeve mjekësore	3 orë
Tema 20	Fazat e fundit të jetës dhe vdekja	2 orë

10 Lënda “Gerontologji e përgjithshme” (L-21-238-25). Kl. 12 – 108 orë

• Synimet e lëndës “Gerontologji e përgjithshme”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Gerontologji e përgjithshme”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë bazat profesionale të përkujdesjes gerontologjike.
- Të përshkruajnë zhvillimin e profesionit të përkujdesjes gerontologjike në ditët e sotme.
- Të përshkruajnë legjislacionin e përgjithshëm dhe institucional në gerontologji.
- Të përshkruajnë aspektet e përkujdesjes gerontologjike.
- Të përshkruajnë veçoritë e fenomenit të plakjes në shoqërinë e sotme.
- Të përshkruajnë mjedisin dhe jetën sociale nga pikëpamja gerontologjike.
- Të përshkruajnë mënyrat e ndryshme të jetesës së të moshuarve, organizimin e mjedisit jetësor, hapësirën dhe kriteret e banimit.
- Të përshkruajnë organizimin e përbashkët shoqëror të të moshuarve dhe përzgjedhjen e aktiviteteve sociale për ta.
- Të përshkruajnë rëndësinë e bashkëveprimit në sigurimin e cilësisë së përkujdesjes gerontologjike.
- Të përshkruajnë strukturën e planit ditor dhe mënyrën e vetë-organizimit të aktiviteteve.
- Të shpjegojnë ushqyerjen e shëndetshme.
- Të shpjegojnë autonominë dhe individualitetin.
- Të përshkruajnë krizat, situatat e vështira dhe mënyrat e përballimit të tyre.
- Të përshkruajnë rregullat e ruajtjes dhe mbrojtjes së shëndetit të personelit.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Gerontologji e përgjithshme”, kl.12- 108 orë

Tema 1	Bazat profesionale të përkujdesjes gerontologjike	6 orë
Tema 2	Zhvillimi i profesionit të përkujdesjes gerontologjike në ditët e sotme	10 orë
Tema 3	Aspekte të legjislacionit të përgjithshëm dhe institucional në gerontologji	8 orë
Tema 4	Aspektet e përkujdesjes për të moshuar	9 orë
Tema 5	Plakja në shoqërinë e sotme. Mjedisi dhe jeta sociale e të moshuarve.	8 orë
Tema 6	Mënyra e jetesës së të moshuarve. Organizimi i mjedisit jetësor, hapësira dhe kriteret e banimit	10 orë
Tema 7	Organizimi shoqëror dhe ofertat sociale për të moshuar.	6 orë
Tema 8	Bashkëveprimi dhe cilësia e përkujdesjes gerontologjike	6 orë
Tema 9	Plani ditor dhe vetë-organizimi i aktiviteteve	6 orë
Tema 10	Ushqyerja e shëndetshme	10 orë
Tema 11	Autonomia dhe individualiteti	6 orë
Tema 12	Krizat dhe situatat e vështira	6 orë
Tema 13	Rregullat e mbrojtjes së shëndetit të personelit	6 orë
Tema 14	Autonomia dhe individualiteti	5 orë
Tema 15	Krizat dhe situatat e vështira	6 orë

11. Lënda “Njohuri mbi ushqyerjen” (L-21-394-25) kl.13 - 64 orë

• Synimet e lëndës “Njohuri mbi ushqyerjen”, kl. 13

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri mbi ushqyerjen” kl. 13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë konceptin bazë të ushqyerjes së shëndetshme.
- Të listojnë lëndët ushqimore bazë dhe rolin e tyre në organizëm.
- Të përshkruajnë normën e konsumimit të lëndëve ushqimore.
- Të shpjegojnë rëndësinë e hartimit të menu-së ushqimore.
- Të shpjegojnë rëndësinë e bashkëpunimit me mjekë dhe dietologë për hartimin e menu-së.
- Të shpjegojnë procedura dhe rëndësinë e sigurimit të produkteve ushqimore.
- Të shpjegojnë rëndësinë e llogaritjes së vlerave ushqimore.
- Të përshkruajnë dieta ushqimore të shëndetshme.
- Të shpjegojnë rëndësinë e lëngjeve në organizëm.
- Të shpjegojnë procesin e përgatitjes së ushqimit për të moshuarin.
- Të shpjegojnë mënyrat e shërbimit të ushqimit për të moshuarin.
- Të shpjegojnë procesin e ushqyerjes së të moshuarit.
- Të shpjegojnë teknikat e ofrimit të ndihmës së parë gjatë ushqyerjes.
- Të përshkruajnë rëndësinë e pastrimit dhe dezinfektimit të mjeteve dhe pajisjeve të ushqyerjes.
- Të shpjegojnë rëndësinë dhe mënyrën e ruajtjes së kampionit ushqimor.
- Të përshkruajë sëmundjet që lidhen me kequshqyerjen.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri mbi ushqyerjen” kl. 13-64 orë**

Tema 1	Koncepti bazë i ushqyerjes së shëndetshme	3 orë
Tema 2	Lëndët ushqimore bazë dhe roli i tyre në organizëm	5 orë
Tema 3	Norma e konsumimit të lëndëve ushqimore	4 orë
Tema 4	Hartimi i menu-së ushqimore	4 orë
Tema 5	Rëndësia e bashkëpunimit me mjekë dhe dietologë për hartimin e menu-së	4 orë
Tema 6	Sigurimi i produkteve ushqimore	4 orë
Tema 7	Llogaritja e vlerave ushqimore	4 orë
Tema 8	Ushqimi dhe dieta ushqimore e shëndetshme	4 orë
Tema 9	Lëngjet dhe rëndësia e tyre në organizëm	4 orë
Tema 10	Procesi i përgatitjes së ushqimit për të moshuarin	4 orë
Tema 11	Mënyrat e shërbimit të ushqimit për të moshuarin	4 orë
Tema 12	Procesi i ushqyerjes së të moshuarit dhe komplikacionet	5 orë
Tema 13	Teknikat e ofrimit të ndihmës së parë gjatë ushqyerjes	4 orë
Tema 14	Pastrimi dhe dezinfektimi i mjeteve dhe pajisjeve të ushqyerjes	4 orë
Tema 15	Mënyrat e ruajtjes së kampionit ushqimor	3 orë
Tema 16	Kequshqyerja dhe sëmundjet	4 orë

12. Lënda “Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i punës” (L-17-750-25) , kl.13 - 64 orë

• **Synimet e lëndës “Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i punës”, kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri mbi ekonominë e shëndetit” kl. 13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë e zbatimit të politikave të mbrojtjes për të moshuarit.
- Të shpjegojnë detyrat dhe përgjegjësitë e kujdestarit për të moshuar.
- Të shpjegojnë rëndësinë e shërbimit socio-shëndetësor për të moshuarit.

- Të klasifikojnë shërbimet socio-shëndetësore për të moshuarit, sipas llojit të tyre.
- Të shpjegojnë organizimin e strukturave të përkujdesjes social-shëndetësore për të moshuar.
- Të përshkruajnë masat për mbrojtjen e shëndetit personal sipas protokolleve shëndetësore.
- Të përshkruajnë hapat e organizimit të vendit të punës.
- Të përshkruajnë teknikat dhe rëndësinë e menaxhimit të kohës.
- Të shpjegojnë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe ndarjes së detyrave.
- Të shpjegojnë rëndësinë e sigurimit dhe menaxhimit të burimeve materiale.
- Të shpjegojnë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike.
- Të shpjegojnë rëndësinë dhe rubrikat e një plani pune.
- Të përshkruajnë fazat e hartimit dhe zbatimit të një planveprimi individual.
- Të përshkruajnë formatet, mënyrat e dokumentimit dhe raportimit të punës.
- Të shpjegojnë domosdoshmërinë e respektimit të rregullave të punës në grup.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i punës”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Politikat e mbrojtjes për të moshuarit	4 orë
Tema 2	Detyrat dhe përgjegjësitë e kujdestarit për të moshuar	9 orë
Tema 3	Klasifikimi i shërbimeve socio-shëndetësore për të moshuarit	4 orë
Tema 4	Organizimi i strukturave të përkujdesjes social-shëndetësore për të moshuar	5 orë
Tema 5	Masat për mbrojtjen e shëndetit personal sipas protokolleve shëndetësore	5 orë
Tema 6	Organizimi i vendit të punës	5 orë
Tema 7	Teknikat dhe rëndësia e menaxhimit të kohës	4 orë
Tema 8	Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe ndarja e detyrave	4 orë
Tema 9	Rëndësia e sigurimit dhe menaxhimit të burimeve materiale	4 orë
Tema 10	Organizimi i vendit të punës në mënyrë ergonomike	4 orë
Tema 11	Hartimi i një plani pune	4 orë
Tema 12	Fazat e hartimit dhe zbatimit të një planveprimi individual	4 orë
Tema 13	Formatet, mënyrat e dokumentimit dhe raportimit të punës	4 orë
Tema 14	Respektimi i rregullave të punës në grup	4 orë

13. Lënda “Kuatr ligjor në fushën e kujdesit për të moshuar” (L-17-396-25), kl. 13 - 64 orë

• **Synimet e lëndës “Kuatr ligjor në fushën e kujdesit për të moshuar në Shqipëri dhe BE”, kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kuatr ligjor në fushën e kujdesit për të moshuar ” kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuadrin ligjor mbi të drejtat e të moshuarit.
- Të respektojnë të drejtat e të moshuarit.
- Të përshkruajnë mënyrat dhe rëndësinë e përfshirjes së të moshuarit në vendimmarrje.
- Të përshkruajnë format dhe mënyrat e parandalimit të rasteve të abuzimit të të moshuarit.
- Të shpjegojnë kuadrin ligjor kombëtar në fushën e shërbimit të kujdesit shëndetësorë për të moshuar.
- Të shpjegojnë kuadrin ligjor mbi vlerësimin dhe komisionimin e aftësisë së kufizuar.

- Të përshkruajnë rëndësinë e sigurisë fizike dhe emocionale gjatë punës me të moshuarin.
- Të përshkruajnë politikat e zhvillimit të shërbimeve të shëndetit mendor për të moshuar.
- Të përshkruajnë politikat e përfshirjes sociale për të moshuar dhe financimi i tyre
- Të përshkruajnë planin kombëtar të veprimit për moshimin.
- Të përshkruajnë kuadrin institucional të mbrojtjes së personave të moshuar.
- Të përshkruajnë proceset e reformimit në sistemin e mbrojtjes social-shëndetësore për të moshuar.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kuari ligjor në fushën e kujdesit për të moshuar”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Kuari ligjor mbi të drejtat e të moshuarit	6 orë
Tema 2	Respektimi i të drejtave për të moshuarit	6 orë
Tema 3	Mënyrat dhe rëndësia e përfshirjes së të moshuarit në vendimmarrje	6 orë
Tema 4	Format dhe mënyrat e parandalimit të rasteve të abuzimit të të moshuarit	6 orë
Tema 5	Kuari ligjor kombëtar në fushën e shërbimit të kujdesit shëndetësor për të moshuar.	6 orë
Tema 6	Kuari ligjor mbi vlerësimin dhe komisionimin e aftësisë së kufizuar	6 orë
Tema 7	Rëndësia e sigurisë fizike dhe emocionale gjatë punës me të moshuarin	4 orë
Tema 8	Politikat e zhvillimit të shërbimeve të shëndetit mendor për të moshuar	6 orë
Tema 9	Politikat e përfshirjes sociale për të moshuar dhe financimi i tyre	4 orë
Tema 10	Plani kombëtar i veprimit mbi moshimin	4 orë
Tema 11	Kuari institucional i mbrojtjes së personave të moshuar	4 orë
Tema 12	Proceset e reformimit në sistemin e mbrojtjes për të moshuarit	6 orë

14. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-24). Kl.13 – 32 orë

• **Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.**

Në përfundim të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”,**

kl.13-32 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 2	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
Tema 3	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
Tema 4	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	3 orë
Tema 5	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
Tema 6	Monitorimi i burimeve mjedisore	3 orë
Tema 7	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 8	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
Tema 9	<u>Veprimtari praktike</u> për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal	3 orë
Tema 10	<u>Veprimtari praktike</u> për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Dhënia e ndihmës së parë”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	DHËNIA E NDIHMËS SË PARË	M-21-244-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që e pajis nxënësin me aftësi për të dhënë ndihmën e parë në raste urgjence, sëmundjesh akute, aksidentesh dhe të tjera rreziqe për jetën, sipas protokolleve dhe metodave të njohura, si dhe për të evidentuar dhe dokumentuar të dhëna të thjeshta menjëherë në vend-ngjarje e gjatë transportit, deri në qendrën mjekësore më të afërt.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi vlerëson urgjencën sipas rastit që paraqitet. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të marrë përsipër të dëmtuarin me të gjitha nevojat që ai paraqet; - të vlerësojë aftësinë e të dëmtuarit për të reaguar/komunikuar; - të përcaktojë shpejtë dhe saktë prioritet e veprimit; - të pozicionojë të dëmtuarin në pozicionin e përshtatshëm; - të vlerësojë gjendjen e komunikimit të të dëmtuarit; - të vlerësojë frymëmarrjen e të dëmtuarit; - të identifikojë vështirësinë në frymëmarrje; - të gjejë pulsën në qafën e të dëmtuarit; - të kontrollojë ritmin dhe fortësinë e pulsit tek i dëmtuari; - të vlerësojë gjakosjen/ hemoragjinë e të dëmtuarit; - të kontrollojë dhe lirojë rrugët e frymëmarrjes; - të vlerësojë madhësinë dhe gravitetin e plagëve; - të vlerësojë dëmtimet kockore; - të vlerësojë dhimbjet e forta; - të vlerësojë ndjenjën e të vjellave dhe të vjellat; - të vlerësojë vështirësinë në frymë-marrje; - të vlerësojë hiperterminë dhe hipoterminë; - të sigurojë transportimin sa më të shpejtë dhe komod të të dëmtuarit; - të raportojë saktë gjendjen e të sëmurit tek ekipi i ambulancës ose i urgjencës; - të zbatojë rregullat e etikës profesionale;

-
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore;
 - të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi jep ndihmën e parë në vendngjarje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të lajmërojë ambulancën saktë sipas procedurës;
- të japë ndihmën e parë në rast hemorragjie;
- të japë ndihmën e parë në plagë të ndryshme;
- të japë ndihmën e parë në rast gjendje shoku;
- të japë ndihmën e parë në rast djegieje;
- të japë ndihmën e parë në rast frakturash;
- të japë ndihmën e parë në rast helmimi;
- të japë ndihmën e parë në rast të fikëti;
- të japë ndihmën e parë në rast ngrirjeje;
- të japë ndihmën e parë në rast goditje nga dielli;
- të japë ndihmën e parë në rast humbje të lëngjeve (dehidrimi);
- të japë ndihmën e parë në rast pickimi nga insektet;
- të japë ndihmën e parë në rast kafshimi nga gjarpëri;
- të japë ndihmën e parë në rast atak zemre;
- të japë ndihmën e parë në rast overdoze;
- të japë ndihmën e parë në rast goditje nga rryma elektrike;
- të zbatojë rregullat e etikës profesionale;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi dokumenton të dhëna të thjeshta.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shënojë emrin, mbiemrin dhe moshën e të dëmtuarit;
- të shkruajë kohën e saktë të dëmtimit;
- të shkruajë të gjitha dëmtimet e vlerësuara tek i dëmtuari;
- të përshkruajë të gjithë ndihmën e dhënë deri në atë moment;
- të përshkruajë vroshtimet e veçanta dhe të rëndësishme për jetën e të dëmtuarit;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	– Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në kabinetet e dhënies së ndihmës së parë. – Gjatë trajtimit të modulit, mësuesi/ instruktori i praktikës duhet të ilustrojë dhe instruktojë në mënyrë sa më korekte nxënësit për të ofruar të gjitha etapat e dhënies së ndihmës së parë. – Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të shprehive që trajton moduli. – Mësuesi/ instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave për dhënien e ndihmës së parë, rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, si dhe mirëmbajtjes së paisjeve. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e dhënies së të gjitha etapave të ndihmës së parë, si dhe të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Mjedis i bollshëm për kryerjen e të gjitha veprimeve gjatë dhënies së ndihmës së parë. – Paisje si: kukulla mësimore e mjete ndihmëse rrethore, për dhënien e ndihmës së parë. – Mteriale të ndihmës së parë të fabrikuara/ kutitë e ndihmës së parë në makina, udhëzuesa, rregullore, protokolle mjekësore, etj.,

2. Moduli “Mjedisi fizik i sigurt për të moshuarit”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MJEDISI FIZIK I SIGURT PËR TË MOSHUARIT	M-05-2201-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të identifikuar dhe zbatuar masa mbrojtëse për krijimin e një mjedisi të sigurt fizik për të moshuarit, në ambiente banimi dhe institucione të kujdesit.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi identifikon rreziqet në mjediset e të moshuarve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përshkruajë karakteristikat fizike dhe psikologjike të të moshuarve që ndikojnë në sigurinë e tyre; – të identifikojë faktorët e rrezikut në shtëpi, në institucion dhe në ambiente të përbashkëta; – të dallojë rreziqet që lidhen me ndriçimin, sipërfaqet rrëshqitëse, mobiliat, etj.; – të evidentojë situatat që rrisin rrezikun e rrëzimit; – të shpjegojë rëndësinë e sigurisë në lëvizje, përdorimin e ndihmësve të ecjes, etj. – të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore; – të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi ndërmerr masa për sigurimin e mjedisit fizik. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të vendosë sinjalistikën për rrugët e qarkullimit të sigurt; – të ndihmojë në përshtatjen ergonomike të ambienteve të brendshme; – të vendosë mbajtëse për duar në korridore dhe tualete; – të kujdeset për rregullsinë dhe pastërtinë e dyshemeve; – të kontrollojë sigurinë e sistemeve elektrike dhe ndriçimit; – të eliminojë objektet që paraqesin pengesa në lëvizje; – të aplikojë masat për parandalimin e rrëzimeve dhe aksidenteve;

- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi harton dokumentacionin dhe realizon ndërgjegjësimin për sigurinë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të këshillojë të moshuarit dhe familjarët për sigurimin e ambienteve të jetesës;
- të japë informacione për risqet dhe masat parandaluese;
- të bashkëpunojë me profesionistë për përmirësimin e mjedisit;
- të plotësojë formularë për risqet dhe masat e marra;
- të mbajë shënime të qarta për veprimet parandaluese;
- të zbatojë rregullat e etikës profesionale;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Moduli duhet të zhvillohet në mjedise të përshtatshme për simulime praktike.
- Mësuesi/instruktori duhet të ilustrojë rreziqet dhe të nxisë nxënësit të gjejnë zgjidhje praktike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në vëzhgime dhe projekte në grupe.
- Duhet të punohet në ndërtimin e një kulture parandaluese për të moshuarit.
- Vlerësimi të fokusohet te demonstrimi i shprehive praktike dhe komunikimi profesional.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet si më poshtë:
- Mjedis praktik (ambient simulimi për banesë ose institucion kujdesi);
 - Pajisje ndihmëse për të moshuarit (mbajtëse duarsh, ndriçim, karroca, paterica);
 - Formularë për dokumentim të rreziqeve dhe masave parandaluese;
 - Postera dhe materiale vizuale informuese;
 - Manuale dhe protokolle të sigurisë për të moshuarit.

3 . Moduli ”Matja e shenjave jetësore të organizmit”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 11

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MATJA E SHENJAVE JETËSORE TË ORGANIZMIT	M-21-252-25
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer matjen e parametrave jetësore të organizmit siç janë frymëmarrja, pulsi e tensioni arterial, si dhe temperatura.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi kryen matjen e frymëmarrjes. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përzgjedhë instrumentin e duhur për të kryer matjen e frymëmarrjes; - të analizojë me kujdes tabelën me parametrat normale të frymëmarrjes sipas grupmoshave; - të informojë të moshuarin për procedurat e matjes së frymëmarrjes; - të pozicionojë të moshuarin për matjen e frymëmarrjes; - të kryejë matjen e frymëmarrjes tek të moshuarit; - të evidentojë dispneë; - të evidentojë vlerat e matura në formularin përkatës; - të zbatojë rregullat e etikës profesionale; - të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore; - të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> - Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi kryen matjen e pulsit dhe tensionit arterial. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përzgjedhë instrumentet e duhura për të kryer matjen e pulsit dhe tensionit arterial; - të analizojë me kujdes tabelën me parametrat normale të pulsit dhe tensionit arterial sipas grupmoshave; - të kontrollojë instrumentat e duhura për gjendjen funksionale të tyre; - të informojë të moshuarin për procedurat e matjes së pulsit

- dhe të tensionit arterial;
- të pozicionojë të moshuarin për procedurat e matjes së pulsit dhe të tensionit arterial;
- të kryejë matjen e pulsit tek të moshuarit;
- të kryejë matjen e tensionit arterial tek të moshuarit;
- të evidentojë problemet e hasura gjatë matjes së pulsit;
- të evidentojë problemet e hasura gjatë matjes së tensionit arterial;
- të zbatojë me përpikmëri procedurat përkatëse për çdo rast;
- të zbatojë rregullat e etikës profesionale;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen matjen e temperaturës së trupit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë termometrin me zhivë për dëmtime të mundshme;
- të rivendosë zhivën në nivelin fillestar, me shkundje ose rigradim;
- të kryejë matjen e temperaturës nën sqetull;
- të kryejë matjen orale të temperaturës;
- të kryejë matjen rektale të temperaturës;
- të përdorë saktë kanjulat njëpërdorimshme tek matjet rektale të temperaturës;
- të përdorë saktë termometrin digjital;
- të kryejë matjen e temperaturës në gjendje qetësie;
- të bëjë kontrollin e shpeshtë në gjendje temperature të lartë;
- të kryejë veprimet e duhura për uljen e temperaturës;
- të pastrojë me kujdes në rast të thyerjes së termometrit me zhivë;
- të shënojë në formularin përkatës orën dhe vlerën përkatëse të temperaturës;
- të zbatojë me përpikmëri rregullat e matjes së temperaturës;
- të zbatojë rregullat e etikës profesionale;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	– Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në kabinetin e kujdesit social-shendetësor, por edhe në spitale, etj, për matjen e shenjave vitale të organizmit. – Gjatë trajtimit të modulit, mësuesi/ instruktori i praktikës duhet të ilustrojë dhe instruktojë në mënyrë sa më korekte nxënësit për të për të kryer matjen e shenjave vitale të organizmit siç janë frymëmarrja, pulsi e tensioni arterial, si dhe temperatura. – Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të shprehive, për matjen e shenjave vitale të organizmit. – Nxënësit vihen në dispozicion të njëri-tjetrit për matjen e shenjave vitale të organizmit. – Mësuesi/ instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave për për matjen e shenjave vitale të organizmit. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për matjen e shenjave vitale të organizmit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe pajisjet si më poshtë: – Kabinet i përkujdesjes. – Aparatet e për matjen e tensionit arterial, stetoskop, termometra, etj. – Rregullore, katalogë, manualë, protokolle etj.

4. Moduli “Zbatimi praktik i recetës dhe i rekomandimeve të mjekut”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	ZBATIMI PRAKTIK I RECETËS DHE I REKOMANDIMEVE TË MJEKUT	M-21-253-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë për të lexuar dhe zbatuar recetat dhe rekomandimet e mjekut.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi zbaton recetën mjekësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë identifikimin e vlerave ligjore të recetës mjekësore; - të lexojë saktë përmbajtjen e recetës. - të kryejë identifikimin e karakteristikave dalluese të recetës mjekësore; - të kryejë identifikimin e së drejtës për lëshimin e recetës; - të dallojë diagnozat mjekësore; - të zbatojë me përpikmëri formën dhe dozimin ; - të zbatojë mënyrën e përdorimit të barnave; - të sqarojë individin në nevojë në rast paqartësie; - të kryejë identifikimin e efekteve të pa dëshiruara të barnave; - të veprojë sipas protokollit mjekësor në rast reaksioni nga medikamentet. - të reagojë sipas protokollit në rast reaksionesh të padëshiruara. - të zbatojë rregullat e etikës profesionale; - të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore; - të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi zbaton rekomandimet mjekësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë identifikimin e procedurave të rekomanduara;

- të informojë pacientin/ familjarët mbi rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të mjekut.
- të përdorë kompresat e të ftohta dhe të ngrohta;
- të përdorë fashaturat;
- të sqarojë pacientin në cdo rast paqartësie;
- të kryejë zbatimin praktik i rekomandimeve përkatëse;
- të kryejë identifikimin e rekomandimeve për pushime;
- të identifikojë efektet e pa dëshiruara të procedurave të rekomanduara;
- të sqarojë marrëdhëniet me raportet mjekësore;
- të zbatojë rregullat e etikës profesionale;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në kabinetet mësimore, në klinika mjekësore, etj.,
- Gjatë trajtimit të modulit, mësuesi/ instruktori i praktikës duhet të ilustrojë dhe instruktojë në mënyrë sa më korekte nxënësit për zbatimin praktik të recetës dhe rekomandimeve mjekësore.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të shprehive për zbatimin praktik të recetës dhe rekomandimeve mjekësore.
- Mësuesi/ instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave për zbatimin praktik të recetës dhe rekomandimeve mjekësore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për zbatimin praktik të recetës dhe rekomandimeve mjekësore, si dhe të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, mjete dhe materialet e mëposhtme:
- Klasa mësimore, klinika mjekësore e qendra shëndetësore, nga ku lëshohen receta dhe rekomandime mjekësore.
 - Formularë, receta përkatëse mjekësore, modularë, si dhe mjete kancelarie.
 - Udhëzues, rregullore, katalogë, protokolle mjekësore, etj.,
-

5. Moduli “Pastrimi, dezinfektimi dhe sterilizimi”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PASTRIMI, DEZINFEKTIMI DHE STERILIZIMI	M-21-248-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer proceset e pastrimit, dezinfektimit dhe sterilizimit të duarve, pajisjeve dhe orendive.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi pastron duart e tij dhe paisjet kirurgjikale. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të pastrojë duart e tij para shpërndarjes së ushqimit dhe të medikamenteve, duke zbatuar procedurat përkatëse; - të pastrojë duart e tij ndërmjet veprimeve të ndryshme për kujdesëse duke zbatuar procedurat përkatëse; - të pastrojë duart e tij pas veprimeve në punët e shtëpisë; - të pastrojë duart e tij para kontaktit me individin në nevojë; - të lajë duart pas çdo kontakti me individin në nevojë; - të pastrojë duart e tij për higjienë personale (pas kollitjes, teshtitjes ose pastrimit të hundëve, pas daljes nga tualeti); - të pastrojë mjetet kirurgjikale; - të pastrojë sendet që përdor individi në nevojë; - të pastrojë orenditë e ndryshme; - të zbatojë rregullat e etikës profesionale; - të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore; - të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi kryen dezinfektimin e mjeteve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përzgjedhë drejt mjetet dhe solucionet për dezinfektim; - të kryejë dezinfektimin kimik me solucion dezinfektues,

- duke respektuar kohën e veprimit;
- të kryejë dezinfektimin kimik me rreze ultraviolet në laborator;
- të kryejë dezinfektimin kimik nëpërmjet presionit të avujve të ujit për 30 minuta;
- të kryejë dezinfektimin kimik me nxehtësi të thatë;
- të kryejë dezinfektimin kimik me zjerje për 20 minuta;
- të kryejë dezinfektimin kimik me pasterizim, duke zbatuar procedurat përkatëse;
- të zbatojë rregullat e etikës profesionale;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen sterilizimin e mjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë drejt mjetet dhe materialet për sterilizim;
- të kryejë sterilizimin me anë të temperaturës, duke zbatuar procedurat përkatëse;
- të kryejë sterilizimin me anë të gazit, duke zbatuar procedurat përkatëse;
- të kryejë sterilizimin me anë të rrezeve, duke zbatuar procedurat përkatëse;
- të zbatojë rregullat e etikës profesionale;
- të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas kërkesave higjieno-shëndetësore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrollit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor ose spitale, shtëpi për të moshuar, etj..
- Gjatë trajtimit të modulit, mësimdhënësi duhet të kryejë demonstrime të sakta praktike për pastrimin, dezinfektimin dhe sterilizimin e duarve, mjeteve e orendive përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për kryerjen e pastrimit, dezinfektimit dhe sterilizimit të duarve, mjeteve dhe orendive.
- Mësuesi/ instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave për kryerjen e pastrimit, dezinfektimit dhe sterilizimit të duarve, mjeteve dhe orendive.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kryerjen e pastrimit, dezinfektimit dhe sterilizimit të duarve, mjeteve dhe orendive.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Kabineti i kujdesit social-shëndetësor, spitale, shtëpi për të moshuar, etj.
 - Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për pastrimin, dezinfekimin dhe sterilizimin e duarve, mjeteve e orendive.
 - Udhëzuesa, rregullore, protokolle etj.
-

6 Moduli “Respektimi i etikës profesionale dhe i të drejtave të të moshuarve”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	RESPEKTIMI I ETIKËS PROFESIONALE DHE I TË DREJTAVE TË TË MOSHUARVE	M-20-1204-25
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson nxënësit të respektojnë të drejtat e të moshuarve me të cilët ata do të punojnë dhe të ruajnë etikën e punës.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) , procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi prezanton veten me gojë dhe me shkrim. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshëndesë të gjithë pjesëmarrësit në takim; - të prezantojë veten me gojë dhe shkrim në mënyrë korrekte; - të dëgjojë më qetësi pyetjet që vijnë nga bashkëbiseduesit; - t’ju përgjigjet me korrektësi pyetjeve që vijnë nga bashkëbiseduesit lidhur me veten e tij, dëshirat, interesat dhe planet për të ardhmen; - të pyesë bashkëbiseduesit rreth vetes duke i dëgjuar me vëmendje; - të zbatojë rregullat bazë të komunikimit. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listëkontrolli. - Pyetësor për pjesëmarrësit.
	RN 2	Nxënësi zbaton rregullat e respektimit të privatësisë së individit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të shikojë me vëmendje filmat e shfaqura apo fotografitë në video-projektor; - të identifikojë situatat e veçanta; - të identifikojë cilët janë elementët e jetës private të individit; - të shpjegojë rëndësinë e respektimit të privatësisë në raste të caktuara dhe me individë të caktuar; - të identifikojë pasojat e shkeljes së të drejtës për privatësi të individit; - të shmangë situatat që mund të pengojnë në punën e tij si kujdestar në lidhje me shkeljen e privatësisë së klientit të

tij;

- të përgatisë posterin nëpërmjet të cilit të përcjellë saktë mesazhe ndërgjegjësimi mbi nevojën e respektimit të të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë të së drejtës për privatësi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Vlerësim me anë të bashkëbisedimit lidhur me raste të prezantuar në klasë nga mësuesi.
- Poster i ideuar nga nxënësi.

RN 3 Nxënësi respekton diversitetin e qënies njerëzore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshëndetet me pjesëmarrësit dhe të marrë rolin që i caktohet (ndihmës social/person i grupit Rom/person me aftësi të kufizuara/ grua e moshuar/ person homoseksual/ grua e divorcuar/fëmijë me Sindromën Down/ epileptik/person i infektuar me virusin HIV etj);
- të studiojë me kujdes veçoritë e rolit që ka marrë;
- të silllet në bazë të asaj çfarë përfaqëson roli i marrë;
- të dëgjojë me vëmendje bashkëbiseduesin (që mund të jetë një person ndryshe);
- të respektojë të drejtën e individit për t'u dëgjuar pavarësisht faktit që ai mund të jetë ndryshe nga njerëzit e tjerë;
- të zbatojë bazën ligjore të detyrimit për të respektuar diversitetin njerëzor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Vlerësim i reagimeve të nxënësve sipas roleve.

RN 4 Nxënësi ofron shërbim dhe mbështetje ndaj të moshuarve në nevojë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshëndetet me pjesëmarrësit dhe të marrë rolin që i caktohet ;
- të studiojë me kujdes veçoritë e rolit që ka marrë;
- të silllet në bazë të asaj çfarë përfaqëson roli i marrë;
- të dëgjojë me vëmendje bashkëbiseduesin;
- t'i ofrojë individit shërbimin dhe mbështetjen e duhur sipas nevojës që ai ka;
- të respektojë të drejtën e individit për shërbim dhe mbështetje;
- të silllet sipas rregullave të caktuara;
- të zbatojë bazën ligjore të detyrimit për të respektuar nevojën për shërbime dhe mbështetje të klientëve të vet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Vlerësim i reagimeve të nxënësve në rolet përkatëse.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul mund të zbatohet në klasë. – Detyrat e nxënësve në klasë përcaktohen nga mësuesi me pranimin e nxënësve. – Mësuesi nuk duhet të shfaqë paragjykime në konceptet e nxënësve mbi diversitetin njerëzor, nevojat diverse të të moshuarve, të drejtën për të qënë të informuar si dhe duhet të prezantojë detyrimin për të respektuar çdo të drejtë tjetër të njeriut.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Klasa të organizohet në formën e një mjedisi ku realizohen marrëdhënie interaktive. – Mundësimi i shfaqjes së disa rasteve të filmuara më parë lidhur me ndërveprimin e ndihmësit social me individë që ju përkasin grupimeve apo drejtimeve të ndryshme. – Mundësimi i vlerësimit të roleve të realizuar nga nxënësit në mënyrë që ata të kuptojnë se çfarë është e duhur dhe çfarë jo në marrëdhënie me njerëzit me karakteristika dhe preferenca të ndryshme.

7. Moduli "Zhvillimi i aktiviteteve argëtuese, kulturore dhe artistike për të moshuarin"
Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE ARGËTUESE, KULTURORE DHE ARTISTIKE PËR TË MOSHUAR	M-20-2202-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë praktike për zhvillimin e aktiviteteve argëtuese, kulturore dhe artistike të të moshuarit.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të kualifikimit profesional "Shërbime kujdesi për të moshuar".	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi planifikon aktivitete argëtuese, kulturore dhe artistike Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë rëndësinë e përfshirjes së të moshuarve në vendimmarrjen për aktivitetet që organizohen; - të identifikojë format e bashkëpunimit me të moshuarin/familjarët/të afërmit për hartimin e kalendarit të aktiviteteve; - të marrë informacion nga i moshuari për aktivitetet e preferuara të tij; - të bashkëpunojë vazhdimisht me të moshuarin/familjarët/të afërmit për hartimin e kalendarit javor/mujor të aktiviteteve; - të evidentojë nevojat specifike të moshuarve pjesëmarrës; - të hartojë një plan menaxhimi të rreziqeve të ndryshme në një aktivitet argëtues, kulturor dhe artistik; - të planifikojë aktivitetet argëtuese, kulturore dhe artistike të përshtatshme për moshën e tretë; - të planifikojë burimet për realizimin e aktiviteteve, sipas llojit të aktivitetit; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit; - të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë punës; - të kryejë llogaritje kostosh. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.	
	RN 2 Nxënësi organizon aktivitete argëtuese, kulturore dhe artistike. Kriteret e vlerësimit:	

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë modele dhe forma organizimi të aktiviteteve argëtuese, kulturore dhe artistike;
- të organizojë aktivitete argëtuese, kulturore dhe artistike brenda dhe jashtë mjedisit të institucionit, sipas planit të aktiviteteve;
- të organizojë aktivitete në kuadër të ditëlindjeve dhe festave zyrtare, sipas kalendarit;
- të shoqërojë dhe monitorojë të moshuarin në aktivitete argëtuese, kulturore dhe artistike, jashtë mjedisit të institucionit, sipas planit;
- të menaxhojë situatat e konflikteve gjatë një aktiviteti argëtues, kulturor dhe artistik;
- të bashkëpunojë me përgjegjësi dhe efektivitet me gjithë pjesëtarët e grupit;
- të mbledhë përshtypjet nga i moshuari lidhur me aktivitetet e kryera, sipas formateve;
- të dokumentojë përshtypjet sipas formateve përkatëse
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë punës;
- të kryejë llogaritje kostosh.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të realizohet në shtëpi për të moshuar, shtëpi banimi.
- Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet të organizojë me korrektësi dhe përkushtim aktivitete argetuese,kulturore dhe artistike.
- Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të përdorin ambiente të ndryshme për të realizuar sa më mirë aktivitetet argëtuese,kulturore dhe artistike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në mënyrë progresive sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari argetuese,kulturore dhe artistike.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
Kabineti i kujdesit social-shëndetësor, spitale, shtëpi për të moshuar, etj.,
Pajisjet dhe artikujt të ndryshëm për realizimin e aktiviteteve argëtuese, kulturore dhe artistike për të moshuarin.
Udhëzuesa, rregullore, protokolle etj.

8. Moduli “Procesi i ushqyerjes për të moshuarit”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PROCESI I USHQYERJES PËR TË MOSHUARIT	M-20-2203-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të realizuar përkujdesjen në ushqyerjen e të moshuarve sipas specifikave të sëmundjes.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës së 11- të të kualifikimit profesional mësimor “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi vlerëson procesin e ushqyerjes <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përcaktojë normën e konsumimit të lëndëve ushqimore; - të theksojë faktoret individualë që ndikojnë në ushqyerje; - të evidentojë devijimet nga pesha normale; - të vëzhgojë tolerancën e tretjes së ushqimit tek i moshuari; - të vlerësojë rëndësinë e lëngjeve në organizëm; - të përcaktojë faktorët që ndikojnë në sjelljen ushqimore; - të vlerësojë rëndësinë e ruajtjes së ushqimeve; - të vlerësojë çrregullimet në të ngrënë; - të aplikojë dietë ushqimore në varësi të specifikave të moshuarit; - të kryejë përkujdesjen në çrregullimet e ushqyerjes; - të kryejë ventilimin e mjedisit para dhe pas ushqyerjes; - të planifikojë ushqyerjen sipas rasteve përkatës; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit. <i>Instrumentat e vlerësimit:</i> Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi ushqen të moshuarin. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë ushqyerjen e të moshuarve; - të kryejë përkujdesjen në diarre; - të kryejë përkujdesjen në konstipacion; - të dokumentojë problematikat gjatë procesit të ushqyerjes; - të menaxhojë situatat emergjente gjatë ushqyerjes; - të kryejë ushqyerjen e të moshuarve me diabet; - të kryejë ushqyerjen e të moshuarve me hipertension; - të krijojë mundësinë që i moshuari të vetë-ushqehet;

- të parandaloje sëmundjet që lidhen me kequshqyerjen e individëve të moshuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN3 Nxënësi vlerëson problematikat e ushqyerjes.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ushqejë të moshuarin në rast pamundësie totale të tij;
- të vrojtojë vetëdijen dhe problemet gjatë gjellitjes;
- të kryejë ushqyerjen e të moshuarve me sondë gastrike;
- të akomodojë të moshuarin në pozicionin e përshtatshëm;
- të ajrosë dhe sistemojë dhomën;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të ndërhyjë në rastet kur i moshuari ka mbetje ushqimi në rrugët e frymëmarrjes;
- të inkurajojë ushqyerjen e të moshuarit në varësi të diagnozës së sëmundjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në klasa teorike, kabinete praktike, shtëpi për të moshuar, spitale, klinika, etj.
- Mësuesi duhet të demonstrojë veprimtari për përkujdesjen në ushqyerjen e të moshuarit.
- Mësimdhënësi dhe personeli socio-shëndetësor duhet të përdorin metodën e simulimit për të realizuar situatat e ndryshme të shërbimit dhe të kujdesit për të moshuar që parashikohen në modulet e praktikës profesionale.
- Nxënësit duhet të përqendrohet dhe angazhohet në punë konkrete në të gjitha procedurat e ushqyerjes.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i zbatimit të njohurive të marra dhe i ushtrimit praktik të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi, njerëzit në nevojë, pajisjet dhe materialet si më poshtë:
- Klase teorie, kabinet praktik, shtëpi për të moshuar, spitale, klinika, etj.
 - Njerëz në nevojë social-shëndetësore ose manekinë.
 - Mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme të shërbimit dhe ushqyerjes ndaj të moshuarve.
 - Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë, etj.
 - Udhëzues, katalogë, rregullore, etj

9 Moduli “Përkujdesja në çrregullimet dhe sëmundjet e aparatit muskuloskeletik të të moshuarit”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA NË ÇRREGULLIMET DHE SËMUNDJET E APARATIT MUSKOLOSKELETIK TE TË MOSHUARIT	M-21-664-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për përkujdesjen në çrregullimet dhe sëmundjet e aparatit muskuloskeletik.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës 11 të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat vlerësimit	RN 1 Nxënësi identifikon çrregullimet dhe sëmundjet e aparatit muskuloskeletik te të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të vlerësojë ndryshimet specifike gjatë plakjes të të moshuarit; – të analizojë dhe regjistrojë situatat përkatëse të të moshuarit; – të identifikojë ndryshimet në mënyrën e të ecurit të të moshuarit; – të identifikojë ndryshimet në mbajtjen e ekuilibrit të të moshuarit; – të identifikojë simptomat e dobësimit të ekstremiteteve të të moshuarit; – të parandalojë fraktura të kockave të të moshuarit; – të sistemojë ambientin për parandalimin e rrëzimeve të të moshuarit; – të studiojë problematikat tipike gjatë përkujdesjes të të moshuarit. Instrumentat e vlerësimit: Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi përkujdeset në dëmtime muskuloskeletike te të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përkujdeset në distorsione; – të përkujdeset në luksatione; – të përkujdeset në fraktura të artikulacioneve;	

- të përkujdeset në arthroza;
- të përkujdeset në kontraktura;
- të përkujdeset në dëmtime të lindura;
- të asistojë në ekzaminime endoskopike;
- të asistojë në matje të densitetit të kockës;
- të asistojë në ekzaminime laboratorike;
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer;
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me të moshuarin;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi përkujdeset në dëmtime dhe sëmundje specifike.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë, sipas manualit, përkujdesjen në Osteoporozë;
- të kryejë, sipas manualit, përkujdesjen në frakturat e femurit;
- të kryejë, sipas manualit, përkujdesjen në Endoproteza totale;
- të kryejë, sipas manualit, përkujdesjen në arthritis Rheumatoid;
- të kryejë, sipas manualit, përkujdesjen në ekstermitete të amputuara;
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer;
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me të moshuarin;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të realizohet në kabinet kujdesi për të moshuar, spitale, shtëpi për të moshuar etj.
- Mësimdhënësi dhe personeli i shërbimit duhet të kryejë demonstrime të sakta praktike për përkujdesje në çrregullime dhe sëmundje të aparatit muskuloskeletik
- Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet të përdorin metodën e simulimit për të realizuar situatat e ndryshme të shërbimit dhe të kujdesit për të moshuar që parashikohen në modulet e praktikës profesionale.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për kryerjen e përkujdesjes në çrregullime dhe sëmundje të aparatit muskuloskeletik
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi të demonstrimi praktik i njohurive dhe aftësive të fituara.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë për të moshuare, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Kabinet kujdesi social-shëndëtsor, spitale, shtëpi për të moshuar etj
 - Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për për për kujdesje ne çrregullime dhe semundje te aparatit muskuloskeletik
 - Njerëz në nevojë për të moshuare ose manekinë
 - Mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme të shërbimit dhe kujdesit ndaj të moshuarve
 - Udhëzues, CD, rregullore etj.
-

10 Moduli “Përkujdesja në çrregullimet e frymëmarrjes dhe në sëmundjet kardiovaskulare të të moshuarit”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA NË ÇRREGULLIMET E FRYMËMARRJES DHE NË SËMUNDJET KARDIOVASKULARE TE TË MOSHUARIT	M-21-663-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për përkujdesjen në çrregullimet e frymëmarrjes dhe në sëmundjet kardiovaskulare.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës së 11- të të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi vlerëson përkujdesjen në çrregullimet e frymëmarrjes dhe të sëmundjeve kardiovaskulare. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë - të analizojë me kujdes tabelën me parametrat normale të frymëmarrjes dhe të pulsit; - të përkujdeset për të moshuarin me çrregullime të frymëmarrjes si: dispne, apne, polipne dhe bradipne; - të pozicionojë të moshuarin për normalizimin e frymëmarrjes; - të përkujdeset për të moshuarin me çrregullime të ritmit të zemrës si: takikardi, bradikardi dhe aritmi; - të analizojë shkaqet që çojnë në çrregullime të ritmit të zemrës; - të analizojë dhe të regjistrojë në kartelë çrregullimet e frymëmarrjes dhe të ritmit të zemrës; - të shoqërojë të moshuarin për ekzaminime radiologjike dhe ekografike. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi kryen përkujdesjen në sëmundjet kardiovaskulare. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë - të përzgjedhë masat e duhura profilaktike; - të ndihmojë të moshuarin në lëvizje; - të kryejë pozicionimin dhe lehtësimin e frymëmarrjes; - të aplikojë ushqyerje të shëndetshme në sëmundjet kardiovaskulare; - të zbatojë përkujdesjen në sëmundjet Koronare;	

- të zbatojë përkujdesjen në Infarktin akut të Myokardit;
- të zbatojë përkujdesjen në Insuficiencën Kardiakë;
- të zbatojë përkujdesjen në Varicosis;
- të zbatojë përkujdesjen në Thrombophlebitis;
- të zbatojë përkujdesjen në Phlebothromboza;
- të zbatojë përkujdesjen në Hypertoni dhe Hypotoni;
- të zbatojë përkujdesjen në Anemi;
- të aplikojë saktë trajtimet dhe terapitë specifike mjekësore;
- të aplikojë edukimin shëndetësor të të moshuarit;
- të veproje drejt në situata emergjente;
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me të moshuarin;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen përkujdesjen në çrregullimet dhe sëmundjet e frymëmarrjes.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë saktë procedurat për lehtësimin e frymëmarrjes;
- të përzgjedhë masat e duhura profilaktike;
- të përkujdeset në rast trakeostomie;
- të veprojë saktë në problemet akute të frymëmarrjes;
- të zbatojë përkujdesjen në Bronchitis;
- të zbatojë përkujdesjen në Asthma Bronchiale;
- të zbatojë përkujdesjen në Emphyzemes Pulmonare;
- të zbatojë përkujdesjen në Pneumoni;
- të zbatojë përkujdesjen në Embolite Pulmonare;
- të zbatojë përkujdesjen në Karcinomat Bronchiale;
- të kryejë edukimin shëndetësor të të moshuarit;
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer;
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me të moshuarin;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë teorike, spitale, klinika, shtëpi për të moshuar.
- Mësuesi dhe personeli duhet të demostrojë qartë përkujdesjen në çrregullime të frymëmarrjes dhe në sëmundje kardiovaskulare.
- Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet të përdorin metodën e simulimit për të realizuar situatat e ndryshme të shërbimit dhe të kujdesit për të moshuar që parashikohen në modulet e praktikës profesionale.
- Nxënësit duhet të angazhohen në rutinën e përkujdesjes së përditshme në klinikat ku trajtohen çrregullime të frymëmarrjes dhe sëmundjet kardiovaskulare.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të nxënësve.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi, njerëzit në nevojë, pajisjet dhe materialet si më poshtë:
 - Klasa-teorie, spitale, klinika, shtëpi për të moshuar etj.
 - Njerëz në nevojë për të moshuare ose manekinë
 - Mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme të shërbimit dhe kujdesit ndaj të moshuarve
 - Materialet ndihmëse për përkujdesje dhe artikuj sanitarë
 - Udhëzuesa, katalogë, rregullore etj.
-

11. Moduli “Përkujdesja në çregullimet dhe sëmundjet e aparatit gastrointestinal dhe atij urogenital të të moshuarit”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA NË ÇREGULLIMET DHE SËMUNDJET E APARATIT GASTROINTESTINAL DHE ATIJ UROGENITAL TE TË MOSHUARIT	M-21-665-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për përkujdesjen në çregullimet dhe sëmundjet e aparatit gastrointestinal dhe urogenital.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës së 11 të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi vlerëson çregullimet dhe sëmundjet e aparatit gastrointestinal dhe atij urogenital. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të identifikojë çregullimet e aparatit gastrointestinal dhe atij urogenital dhe t'i dokumentojë ato; - të vlerësojë simptomat e çregullimeve të aparatit gastrointestinal si: disfagi, hematemezë, melena, konstipacion, diarre, nauze, vemitus, anoreksi, refluks ezofagial, krampe abdominale, etj; - të vlerësojë simptomat e çregullimeve të aparatit urogenital si: anuri, poliuri, dizuri, kolica renale, hematuri, edema, etj; - të instruktojë të moshuarin për përballimin e çregullimeve të aparatit gastrointestinal dhe urogenital; - të përkujdeset për higjienën e të moshuarit; - të marrë kampionin e urinës për ekzaminim; - të shoqërojë të moshuarin për ekzaminime radiologjike dhe endoskopike. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.	
	RN 2 Nxënësi përkujdeset në çregullimet dhe sëmundjet e aparatit gastrointestinal. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë, sipas manualit, përkujdesjen në Abdomen akut;	

- të kryejë sipas manualit perkujdesjen në entero dhe urostma;
- të kryejë, sipas manualit, perkujdesjen në sëmundje të kavitetit të gojës;
- të kryejë, sipas manualit, perkujdesjen në sëmundjet e stomakut;
- të kryejë, sipas manualit, perkujdesjen në sëmundje të zorrës së trashë(colit,fisura anale,hemoroide etj);
- të kryejë, sipas manualit, perkujdesjen në sëmundje të tëmthit;
- të kryejë, sipas manualit, perkujdesjen në kancerin e stomakut;
- të kryejë sipas manualit perkujdesjen në kancerin e colonit;
- të kryejë sipas manualit perkujdesjen ne ileus
- të përgatitë të moshuarin për fibrogastroskopi dhe colonoskopi;.
- të asistojë në ekzaminime rektale;
- të kryejë marrjen e analizave të feçeve;
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer;
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me të moshuarin;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi perkujdeset në çregullimet dhe sëmundjet e aparatit urogenital.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të kryejë perkujdesjen në sëmundje të veshkave;
- të kryejë perkujdesjen në insuficiencë renale;
- të kryejë perkujdesje në infeksione urinare;
- të kryejë perkujdesjen në sëmundje të organeve seksuale femërore;
- të kryejë perkujdesjen në Prolaps;
- të kryejë perkujdesjen në sëmundje të organeve seksuale mashkullore;
- të kryejë perkujdesjen në Prostata;
- të kryejë perkujdesjen në Phimoza;
- të kryejë perkujdesjen në tumore;
- të asistojë në punksiione dhe biopsi;
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer;
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me të moshuarin;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të realizohet në kabinet kujdesi për të moshuar, spitale, shtëpi për të moshuar etj. – Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet të kryejë demonstrime të sakta praktike për përkujdesjen në çregullime dhe sëmundje të aparatit gastrointestinal dhe atij urogenital. – Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet të përdorin metodën e simulimit për të realizuar situatat e ndryshme të shërbimit dhe të kujdesit për të moshuar që parashikohen në modulet e praktikës profesionale. – Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për kryerjen e përkujdesjes në çregullime dhe sëmundje të aparatit gastrointestinal dhe atij urogenital. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te demonstrimi praktik i njohurive dhe aftësive të fituara.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë për të moshuar, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Kabinet kujdesi për të moshuar, spitale, shtëpi për të moshuar etj. – Pajisjet, mjetet ndihmëse dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për zhveshjen, larjen, dhe veshjen e të moshuarit në nevojë për të moshuar. – Njerëz në nevojë për të moshuar ose manekinë. – Udhëzues, CD, rregullore etj.

12. Moduli “Përkujdesja në çrregullimet dhe sëmundjet e dëgjimit, shikimit dhe ato neuropsikiatrike të të moshuarit”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA NË ÇRREGULLIMET DHE SËMUNDJET E DËGJIMIT, SHIKIMIT DHE ATO NEUROPSIKIATRIKE TE TË MOSHUARIT	M-21-667-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë praktike për përkujdesjen në çrregullimet dhe sëmundjet e dëgjimit, shikimit dhe ato neuropsikiatrike.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës së 11- të të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi përkujdeset në çrregullimet dhe sëmundjet e dëgjimit dhe shikimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të vrojtojë të moshuarin; - të mbeshtesë në perceptimin e situatës; - të kryejë veprimet me të moshuarit që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë; - të kryejë vendosjen e sigurisë; - të japë ndihmën në mungesë të dëgjimit dhe shikimit; - të kryejë veprimet me aparatet e dëgjimit dhe lentet e kontaktit; - të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer; - të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me të moshuarin; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit. Instrumentat e vlerësimit: Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi përkujdeset në çrregullimet dhe sëmundjet neuropsikiatrike Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jete i aftë: - të kryejë veprimet e duhura në probleme specifike të përkujdesjes; - të kryejë përkujdesjen në rast Apopleksi, insult cerebral - të kryejë përkujdesjen në sëmundjen Parkinson;

- të kryejë përkujdesjen në Skleroza multiple;
 - të kryejë përkujdesjen në gjendjet komatoze;
 - të kryejë përkujdesjen në semundjet e nervave periferike si paraliza faciale etj.;
 - të kryejë përkujdesjen në inflamacione dhe infeksione si meningitis etj.;
 - të kryejë përkujdesjen në demitimet trauatike te trurit dhe medules spinale.;
 - të asistojë në ekzaminime;
 - të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer;
 - të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me të moshuarin;
 - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit.
- Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të realizohet në spitale, shtëpi për të moshuar, shtëpi banimi për përkujdesjen në çrregullimet dhe sëmundjet e dëgjimit, shikimit dhe ato neuropsikiatrike. – Mësimdhënësi si dhe personeli shëndetësor duhet demonstrojë me korrektësi dhe përkushtim përkujdesjen në çrregullimet dhe sëmundjet e dëgjimit, shikimit dhe ato neuropsikiatrike. – Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet të përdorin metodën e simulimit për të realizuar situatat e ndryshme të shërbimit dhe të kujdesit për të moshuar që parashikohen në modulet e praktikës profesionale. – Nxënësit duhet të angazhohen në mënyrë progresive sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari konkrete praktike të përkujdesjes ndaj të moshuarve në çrregullimet dhe sëmundjet e dëgjimit, shikimit dhe ato neuropsikiatrike. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme: – Spitale, klinika, shtëpi të moshuarish,etj. – Formularë të përgatitur përkatësisht për përkujdesjen në çrregullime dhe semundje hormonale edhe infektive. – Manekinë dhe mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme. – Udhëzues, CD, rregullore, manualë, fatura financiare etj.

13. Moduli : Bashkëpunimi me familjen/të afërmit e të moshuarit

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	BASHKËPUNIMI ME FAMILJEN/TË AFËRMIT E TË MOSHUARIT	M-20-2204-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të qenë efektivë në bashkëpunimin me familjarët/të afërmit e të moshuarit, si aktorë shumë të rëndësishëm në sigurimin e cilësisë së shërbimeve dhe jetesës për të moshuarin.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës së 11- të të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi komunikon në mënyrë profesionale dhe empatike me familjarët/të afërmit e të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përdorë teknika të komunikimit efektiv, si dëgjimi aktiv, perifrazimi për të siguruar kuptueshmëri dhe qartësi; – të përshtasë komunikimin me familjarët/të afërmit e të moshuarve, duke konsideruar moshën, nivelin e edukimit, kulturën etj.; – të demonstrojë empati dhe ndjeshmëri, duke kuptuar ndjenjat, shqetësimet e familjarëve/të afërmeve të të moshuarit; – të përdorë intonacion zëri profesional dhe të qetë edhe në situata të ngarkuara emocionale; – të japë informacion të saktë dhe të qartë për të moshuarin, duke ruajtur limitet profesionale dhe etike; – të veshë uniformën profesionale në vendin e punës; – të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë veprimtarisë profesionale; – të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale; – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me të moshuarin; – të respektojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale, si dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës; – të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë punës; – të kryejë llogaritje kostosh. Instrumentat e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli	

RN 2 Nxënësi respekton pritshmëritë dhe shqetësimet e familjarëve/të afërmve, duke ruajtur autonominë e të moshuarit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dëgjojë me vëmendje pritshmëritë e familjarëve/të afërmve të të moshuarit;
- të balancojë kërkesat e familjarëve /të afërmve me të drejtat e të moshuarit, që të mos çenohet autonomia dhe dinjiteti i tij;
- të shpjegojë qartë familjarëve rëndësinë e respektimit të autonomisë së të moshuarit;
- të zbatojë strategji për të menaxhuar mirë pritshmëritë e familjarëve me nevojat reale të të moshuarit;
- të respektojë limitet profesionale dhe etikën, në funksion të interesit më të lartë të të moshuarit;
- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës.
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë veprimtarisë profesionale;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me të moshuarin;
- të respektojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale, si dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë punës;
- të kryejë llogaritje kostosh.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi menaxhon situata të vështira/konflikte në marrëdhënien: kujdestar-familjar/i afërm.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë shkaqet e konfliktit duke analizuar burimin e tensionit mes familjarëve dhe kujdestarit;
- të komunikojë në mënyrë të qetë dhe konstruktive;
- të përdorë perifrazimin;
- të përdorë teknika të zgjidhjes së konflikteve, si negociimi, ndërmjetësimi për të gjetur zgjidhje;
- të ruajë profesionalizmin dhe paanshmërinë, duke respektuar të drejtat e të gjithëve;
- të vendosë kufinj të qartë në komunikim dhe në detyra për të parandaluar keqkuptimet;
- të kërkojë mbështetje nga kolegë/supervizor për të adresuar çështje profesionale;
- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë, gjatë veprimtarisë profesionale;

- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me të moshuarin;
- të respektojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale, si dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë punës;
- të kryejë llogaritje kostosh.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të realizohet në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor, spitale, shtëpi përkujdesi për të moshuar, qendra ditore/rezidenciale për të moshuar etj.
- Mësimdhënësi dhe personeli i shërbimit duhet të kryejë demonstrime të sakta praktike për komunikimin e kujdestarit me familjarët/të afërmit e të moshuarit.
- Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet të përdorin metodën e simulimit dhe role play për të realizuar situatat e ndryshme të shërbimit dhe të kujdesit për të moshuar, që parashikohen në këtë modul.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për mënyrat komunikimit dhe bashkëpunimit me familjarët/të afërmit e të moshuarit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi të demonstrimi praktik i njohurive dhe aftësive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë social-shëndetësore, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Kabinet kujdesi social-shëndetësor, spitale, shtëpi përkujdesi për të moshuar, qendra ditore/rezidenciale për të moshuar.
 - Pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për përkujdesje në çrregullime dhe sëmundje të aparatit muskuloskeletik të të moshuarit.
 - Njerëz në nevojë social-shëndetësore ose manekinë.
 - Mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme të shërbimit dhe kujdesit ndaj të moshuarve
 - Udhëzues, protokolle të punës me të moshuar, ppt, strategji komunikimi, CD, rregullore, fatura financiare etj.
-

14. Moduli “Hapja dhe mbyllja e një biznesi në shërbimin social-shëndetësor”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HAPJA DHE MBYLLJA E NJË BIZNESI NË SHËRBIMIN SOCIAL - SHËNDETËSOR	M-17-826-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer procedurat për hapjen dhe mbylljen e një biznesi në shërbimin social social-shëndetësor.	
Kohëzgjatja e modulit	64 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës së 12 në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat vlerësimit	RN 1	Nxënësi identifikon procedurat ligjore dhe administrative për hapjen e një biznesi. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të bëjë analizën e përparësive dhe mangësive të llojeve të ndryshme të ideve të biznesit; - të përzgjedhë idenë e hapjes së biznesit (hapja e një biznesi të ri, blerja e një biznesi ekzistues, etj); - të përzgjedhë llojin e shërbimit apo asistencës social-shëndetësore që do të ofrojë biznesi i ri; - të analizojë kuadrin ligjor lidhur me biznesin social-shëndetësor; - të shpjegojë procedurat për regjistrimin e biznesit në gjykatën e rrethit; - të shpjegojë procedurat për regjistrimin e biznesit në drejtorinë e tatimeve; - të shpjegojë procedurat për regjistrimin e biznesit në drejtorinë e taksave vendore; - të shpjegojë procedurat për regjistrimin e biznesit në qendrën kombëtare të regjistrimit (QKR); - të shpjegojë procedurat për regjistrimin e biznesit në qendrën kombëtare të licensimit (QKL). <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> - Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN2	Nxënësi harton planin e biznesit <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përcaktojë qartë qëllimet dhe objektivat e biznesit social- shëndetësor;

- të përcaktojë saktë misionin e biznesit social- shëndetësor;
- të bëjë analizën e tregut të shërbimit social- shëndetësor;
- të hartojë planin e financimit të biznesit social-shëndetësor;
- të përcaktojë vendndodhjen e biznesit social- shëndetësor;
- të hartojë planin -marketing të biznesit social-shëndetësor;
- të hartojë planin e menaxhimit të biznesit social-shëndetësor;
- të përcaktojë saktë strukturën organizative të biznesit që do të krijohet;
- të përcaktojë burimet njerëzore të biznesit;
- të përcaktojë ekipin menaxhues dhe stafin drejtues;
- të përcaktojë procedurat e rekrutimit të stafit;
- të vendosë emrin e biznesit social-shëndetësor;
- të përcaktojë elementet përfaqësues të identitetit të sipërmarrjes (logo dhe moto e veprimtarisë së biznesit);
- të bashkëngjijë shtojca të nevojshme të planit të biznesit (artikuj, diagrame, kontrata, informata të detajuara financiare, patentë, informata të produkteve, listën e çmimeve, broshura, buletin informativ dhe skica teknike);
- të paraqesë dokumentacionin dytësor të biznesit (kopja e kontratës së françizës dhe gjitha dokumentet dytësore të siguruara nga koncesionari, kopja e qirasë së propozuar ose marrëveshja e blerjes për ndërtimin e hapësirës, kopje e licencës apo dokumenteve tjera ligjore, kopje e C.V. së stafit drejtues, etj);
- të hartojë deklaratën e qëllimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi hap biznesin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të simulojë regjistrimin e biznesit në gjykatën e rrethit;
- të simulojë regjistrimin e biznesit në drejtorinë e tatimeve;
- të simulojë regjistrimin e biznesit në drejtorinë e taksave vendore;
- të simulojë regjistrimin e biznesit në qendrën kombëtare të regjistrimit (QKR);
- të regjistrojë i biznesit në qendrën kombëtare të licensimit (QKL);
- të hartojë rregulloren e brendshme të biznesit;
- të simulojë rekrutimin e stafit dhe punonjësve;
- të promovojë biznesin e ri;
- të hapë dyert për komunitetin që të vizitojë qendrën; dhe të informohet për të gjitha çështjet që iu interesojnë;
- të komunikojnë me klientët e interesuar për shërbimet e qendrës;
- të lidhin dhe nënshkruajnë kontrata me klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi mbyll biznesin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë vendimin për mbylljen e biznesit duke e argumentuar atë;
- të llogarisë kostot dhe shpenzimet e procesit të mbylljes së biznesit;
- të bëjë njoftimin zyrtar administrativ për vendimin për mbylljen e biznesit;
- të bëjë anulimin e lejes, licencës dhe emrit të biznesit;
- të paguajë taksat dhe borxhet;
- të njoftojë kreditorët për mbylljen e biznesit;
- të njoftojë furnitorët për mbylljen e biznesit;
- të njoftojë sigurimet shoqërore për mbylljen e biznesit;
- të njoftojë partnerët dhe bashkëpunëtorët për mbylljen e biznesit;
- të njoftojë qiradhënësin për mbylljen e biznesit sipas kushteve të kontratës;
- të njoftojë stafin dhe punonjësit për mbylljen e biznesit jo më vonë se dy javë përpara;
- të njoftojë klientët për mbylljen e biznesit;
- të kryejë procedurat për mbylljen e llogarive bankare të biznesit dhe anulimin e kartave të kreditit;
- të përmbushë shërbimet dhe detyrimet sipas kontratave të lidhura si edhe mbylljen e projekteve;
- të kthejë çdo depozitë apo pagesë për shërbime që nuk janë ofruar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në një biznes social-shëndetësor, qendër ditore ose rezidenciale të cilat ofrojnë shërbime social-shëndetësore, shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore komunitare, etj.
- Mësuesi dhe referenti i qendrës duhet të përfshijë sa më shumë të jetë e mundur nxënësin në procedurat e përditshme konkrete të institucionit, situata të komplikuar, situata që lidhen me nevoja specifike në rrethana specifike.
- Mësuesi dhe referenti i qendrës duhet të krijojnë kushtet e përshtatshme për nxënësit në mënyrë që ata të simulojnë të gjitha procedurat e hapjes dhe mbylljes së një biznesi në fushën e shërbimeve social - shëndetësore.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për të njohur legjislacionin në fuqi mbi të cilin ngrihet biznesi social-shëndetësor dhe të gjitha procedurat për hapjen dhe mbylljen e një biznesi në fushën e shërbimeve social - shëndetësore.
- Vlerësimin e nevojave aktuale dhe mundësitë që ofron qendra për përmbushjen e tyre.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen kontaktet me bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore ditore, rezidenciale, komunitare si dhe direkt në familje për njerëzit në nevojë.
 - Këshillohet që orët e praktikës profesionale të realizohen konkretisht në bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore ditore, rezidenciale, komunitare sidhe direkt në familje për njerëzit në nevojë ku do të ndiqen nga mësuesi në bashkëpunim me referentin/presoni i kontaktit në qendër .
 - Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë etj.
 - Udhëzuesa, katalogë, rregullore etj.
-

15 Moduli “Menaxhimi i përkujdesjes shëndetësore në një qendër të shërbimit social-shëndetësor”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MENAXHIMI I PËRKUJDESJES SHËNDETËSORE NË NJË QENDËR TË SHËRBIMIT SOCIAL–SHËNDETËSOR	M-17-827-25
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson nxënësit për të kryer hartimin dhe zbatimin e planit të kujdesit dhe të planit të shëndetit, plotësimin e raporteve të ecures për çdo klient, kujdesin për jetën sociale në qendër, lidhjet me komunitetin dhe autonominë e zgjedhjes, mbrojtjen e të drejtave të klientëve dhe ushqyerjen e tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	64 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës së 12 në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN1	Nxënësi bën hartimin dhe zbatimin e planin të kujdesit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të plotësojë me kujdes formularin me të dhënat e klientit; - të intervistojë drejtperdrejtë klientin për vlerësimin e nevojave; - të caktojë një punonjës për vlerësimin e nevojave multidisiplinare të klientit; - të vlerësojë nevojat mjekësore të klientit së bashku me ekipet e profesionisteve duke përcaktuar dhe mënyrën e plotësimit të tyre; - të vlerësojë nevojat jetësore të klientit; - të hartojë raportin mbi gjendjen aktuale të klientit; - të hartojë raportin e plotë të vlerësimit të nevojave dhe të ecures së klientit; - të vërë në dispozicion formularët për stafit profesional që punon drejtpërsëdrejti me klientin. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. - Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës. - Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër.
	RN 2	Nxënësi bën hartimin dhe zbatimin e planit të shëndetit Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë saktë shërbimet shëndetësore në planin e shëndetit

- të përshkruajë zhvillimet emocionale, sjelljen;
- të përshkruajë saktë paraqitjen dhe aftësitë vetëkontrolluese të klientit;
- të përshkruajë nevojat e identifikuara të klientit
- të përcaktojë masat e duhura për plotësimin e nevojave të identifikuara;
- të përcaktojë afatet e realizimit, personat përgjegjës dhe rezultatet e pritshme;
- të dokumentojë me kujdes të gjitha mjekimet, trajtimet dhe ndihmën e parë që do marrin klientet;
- të respektojë të drejtën për zgjedhjen e gjinisë së mjekut ose të personelit shëndetësor;
- të kryejë procedurat e veçanta shëndetësore me autorizimin dhe porosinë me shkrim të mjekut;
- të vendosë kontakte të ngushta me specialistë të shëndetit për nevoja të veçanta shëndetësore;
- të ndërgjegjësojë klientin për rreziqet që sjellin për shëndetin duhanpirja, alkooli dhe përdorimi i substancave të tjera;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi plotëson raportin e ecurisë

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë përmbushjen e përgjegjësiave gjatë zbatimit të planit të shërbimeve;
- të monitorojë respektimin e afateve të vlerësimit;
- të monitorojë progresin e shërbimeve të klientit;
- të analizojë zbatimin e planit të shërbimeve;
- të rishikojë planin e shërbimeve;
- të pasqyrojë ndryshimet dhe rekomandimet e ekspertëve në planet e kujdesit të klientit;
- të sigurojë përfshirjen e klienteve në procesin e analizës dhe rishikimit të planeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi përkujdeset për jetën sociale në qendër, lidhjet me komunitetin dhe autonominë e zgjedhjes.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë planin e aktiviteteve sociale në bashkëpunim me klientët;
- të rishikojë realizimin e planit mujor të aktiviteteve sociale;
- të krijojë kushtet për përfshirjen e klientëve në aktivitete të shumëllojshme në grup sipas zgjedhjes së tyre;
- të respektojë të drejtën e klientit për të pritur vizitorë dhe të marrë në aktivitete dhe gëzime familjare;
- të respektojë të drejtën e klientit për të vendosur për jetën e tyre dhe për të përfutur ndihmën e kërkuar;

- të përfshijë klientin në vendimarrjen për shërbimet dhe rregullat e vendosura për orarin e ngrënies, aktivitetet, orarin e fjetjes, pritjes së vizitorëve etj.;
- të nxisë tek klientët autonominë e zgjedhjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës.
- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër.

RN 5 Nxënësi respekton të drejtat, intimitetin dhe dinjitetin e klientëve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë të drejtat ligjore të mbrojtjes nga abuzimet financiare, psikologjike, fizike dhe seksuale;
- të identifikojë informacionin dhe procedurat e duhura për të siguruar respektimin e të drejtave për intimitet të klientit;
- të sigurojë privatësinë gjatë kryerjes së shërbimeve të higjienës tek klientet që janë aftë fizikisht;
- të ndihmojë në krijimin e mundësisë që klientët të marrin pjesë në procesin politik dhe në votime sipas dëshirës;
- të ndihmojë në zbatimin e kriterëve dhe sanksioneve për personelin në shkelje të rregulloreve të brendshme;
- të raportojë rastet e abuzimit tek personat/organet kompetente;
- të ndihmojë në inspektimin e ankesave me seriozitet dhe në kohën e duhur;
- të nxisë pavarësinë për shërbimet e kujdesit higjienik duke zbatuar planin e kujdesit;
- të zbatojë programimin e procedurave të posaçme për shërbimet që ofrohen për intimitet të klientit gjatë shërbimeve personale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi siguron vaktet e ngrënies dhe përkujdeset për ushqyerjen e klientit

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë klientët me kërkesa të veçanta ushqimore;
- të hartojë menunë ushqimore për klientët në përputhje me kërkesat dietike individuale dhe kërkesat ushqimore të moshës dhe gjendjes shëndetësore;
- të hartojë listën ushqimore të institucionit duke patur parasysh sasinë e cilësinë ushqimore për klientët me nevoja dietike të veçanta;
- të sigurojë furnizimin e institucionit me të gjitha produktet ushqimore të planifikuara;
- të përfshijë klientët në planifikimin e menusë, blerjen e ushqimeve, përgatitjen e vakteve, orarin e ngrënies dhe shtrimin e tavolinës për ngrënie;

- të përgatisë vaktet duke zbatuar kërkesat individuale ushqimore të klientëve në përputhje me kërkesat dietike dhe ushqimore të moshës dhe gjendjes shëndetësore;
- të ushqejë klientët në rast të pamundësisë së tyre;
- të intervistojë klientët për plotësimin e standardeve të ushqimit të tyre;
- të respektojë të drejtën e klientit për të mbajtur disa ushqime e për të përgatitur pije për vete dhe për vizitorët e tij.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në një biznes social-shëndetësor, qendër ditore ose rezidenciale të cilat ofrojnë shërbime social-shëndetësore, shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore komunitare, etj.
- Mësuesi duhet të përzgjedhë me kujdes dhe të vendosë kontakte me institucione të ndryshme që ofrojnë shërbime social-shëndetësore.
- Mësuesi së bashku me referentin/ personin e kontaktit duhet të përpilojë formularët e vlerësimit dhe detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër.
- Mësuesi së bashku me referentin/ personin e kontaktit shoqëron secilin nxënës në prezantimin e parë me klientin
- Mësuesi duhet të bëjë vizita sa më të shpeshta në qendër dhe të ketë kontakte të vazhdueshme për të vlerësuar procesin e përfitimit të njohurive dhe aftësive praktike

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen kontaktet me bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore ditore, rezidenciale, komunitare si dhe direkt në familje për njerëzit në nevojë.

Të sigurohet një marrëveshje tip midis shkollës dhe këtyre institucioneve.

Këshillohet që orët e praktikës profesionale të realizohen konkretisht në bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore ditore, rezidenciale, komunitare sidhe direkt në familje për njerëzit në nevojë ku do të ndiqen nga mësuesi në bashkëpunim me referentin/presoni i kontaktit në qendër.

Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë etj.

Udhëzuesa, katalogë, rregullore etj.

16. Moduli “Mirëmbajtja e qendrës së shërbimit për të moshuar dhe administrimi i dokumentacionit të saj”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MIRËMBAJTJA E QENDRËS SË SHËRBIMIT PËR TË MOSHUAR DHE ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT TË SAJ	M-17-1206-25
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson nxënësit për të kryer sistemin e mjediseve dhe pajisjeve, mirëmbajtjen dhe shërbimet ndihmëse, si edhe administrimin e dokumentacionit të një qendre të shërbimit social - shëndetësor.	
Kohëzgjatja e modulit	64 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës së 12 në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi sistemon mjediset dhe pajisjet e qendrës së shërbimit social – shëndetësor. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përcaktojë ambjentet e përbashkëta për ndenje, aktivitete, ngrënie etj, sipas manualit përkatës; - të kryejë mobilimin e dhomës së gjumit duke patur parasysh plotësimin e nevojave jetike të klientëve; - të pranojë mbajtjen e sendeve personale të klientëve; - të interesohet për furnizimin e rregullt me ujë, elektricitet dhe ngrohje/ftohje; - të interesohet për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe mbrojtjen nga zjarri. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. - Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës. - Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër.
	RN 2	Nxënësi kryen mirëmbajtjen dhe shërbimet ndihmëse të qendrës së shërbimit social – shëndetësor. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të mirëmbajë aparaturat dhe teknikën e qendrës së shërbimit social – shëndetësor; - të kryejë administrimin e shërbimeve sipas organigramës së personelit; - të vlerësojë gjendjen higjieno - sanitare të mjediseve të qendrës, dhomave, tualeteve, oborrit, kopshtit etj.;

- të kryejë shërbimin e hotelerisë për sigurimin e ushqyerjes, fjetjes dhe rregullimit të dhomave;
- të kryejë shërbimin e lavanterisë dhe mirëmbajtjes së veshjeve, mbulesave, perdeve, veshmbathje, etj.;
- të kryejë shërbimin e transportit për klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i azilit.
- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër.

RN 3 Nxënësi administron dokumentacionin e qendrës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë rregullat për administrimin e dokumentacionit të qendrës;
- të organizojë dhe sistemojë dokumentacionin sipas kriterëve përkatëse;
- të sigurojë dokumentacionin sipas rregullave të sigurisë;
- të arkivojë dokumentacionin sipas rregullave të arkivës
- të verifikojë dokumentacionin;
- të vlerësojë dokumentacionin sipas kriterëve përkatëse;
- të inspektojë dokumentacionin sipas rregullave;
- të garantojë konfidencialitetin e dokumentacionit të klientit dhe të personelit;
- të zbatojë legjislacioni përkatës për administrimin e dokumentacionit në qendër;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës.
- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në një biznes social-shëndetësor, qendër ditore ose rezidenciale të cilat ofrojnë shërbime social-shëndetësore, shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore komunitare, etj.
- Mësuesi/personeli i qendrës duhet të përzgjedhë me kujdes që nxënësi të vendos kontakte miqësore me klient të përshtatshëm duke respektuar pëlqimin e këtij të fundit.
- Mësuesi dhe personeli i qendrës duhet të shoqërojnë secilin nxënësi në prezantimin e parë me klientin.
- Mësuesi duhet të bëjë vizita sa më të shpeshta në qendra dhe të ketë kontakte të vazhdueshme për procesin e përfitimit të njohurive dhe zbatimit të aftësive praktike.
- Nxënësi kryen veprimet e tij mundësisht gjithnjë me të njëjtët klient.
- Nxënësit i duhet krijuar mundësia të marrë pjesë në administrimin e dokumentacionit të qendrës.
- Moduli testohet në qendër.

Kushtet e domosdoshme

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen kontaktet me bizneset, institucionet, qendrat si dhe

**për realizimin e
modulit**

shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore ditore, rezidenciale, komunitare si dhe direkt në familje për njerëzit në nevojë.

- Të sigurohet një marrëveshje tip midis shkollës dhe këtyre institucioneve.
 - Këshillohet që orët e praktikës profesionale të realizohen konkretisht në bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore ditore, rezidenciale, komunitare si dhe direkt në familje për njerëzit në nevojë ku do të ndiqen nga mësuesi në bashkëpunim me referentin/presoni i kontaktit në qendër.
 - Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë etj.
 - Dokumentacioni përkatës i qendrës
 - Udhëzuesa, katalogë, rregullore etj.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyrues

1. Moduli “Aktivizimi dhe angazhimi social i të moshuarit”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	AKTIVIZIMI DHE ANGAZHIMI SOCIAL I TË MOSHUARIT	M-20-1209-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të nxitur aktivizimin dhe angazhimin e të moshuarit në jetën sociale.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyrues 9 – vjeçar.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat vlerësimit	RN 1	Nxënësi organizon festa për të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përzgjedhë tematikën së festës; - të përzgjedhë bashkëpunëtorët; - të përcaktojë ambjentin; - të hartojë agjendën e festës; - të përzgjedhë elementët argëtues për të moshuarit; - të hartojë listën e të ftuarve; - të dekorojë ambjentin; - të përzgjedhë ushqimin dhe pijet. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. - Pyetësor për pjesëmarrësit.
	RN 2	Nxënësi nxit krijimin dhe mbështet punët artizanale. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përzgjedhë llojin e punimeve artizanale; - të përzgjedhë mjetet e punës sipas rastit; - të nxisë punimin artizanal në qëndisje; - të nxisë punimin me grep dhe shtiza; - të nxisë punimit me mbushje dhe pikturat e qëndisura; - të mbështesë punën dhe krijimin me letër; - të mbështesë punimin drurit, qeramikës, gipsit etj.; - të nxisë punët në kopësht; - të nxisë ushtrimin e përvojave profesionale të të moshuarve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Kontrolli i produktit artizanal të prodhuar.

RN 3 Nxënësi organizon lojra për stërvitjen e kujtesës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë lojra të projektuara për nxitjen e të menduarit;
- të përzgjedhë e mjetet e nevojshme sipas rastit;
- të ndihmojë në plotësimi e fjalëkryqit;
- të organizojë zhvillimin e lojrave me numra për ruajtjen e kujtesës;
- të ndihmojë mësimin përmendësh të pjesëve të ndryshme;
- të përzgjedhë librat, revistat e përshtatshme, etj.;
- të organizojë zhvillimi e lojra me letra në grup, etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul mund të zbatohet në shtëpinë e kujdesit për të moshuar.
- Detyrat e nxënësve përcaktohen nga mësuesi me pranimin e nxënësve.
- Mësuesi duhet të shfaqë gatishmëri, durim dhe krijimtari për të nxitur nxënësit të luajnë dhe të aktivizojnë të moshuarit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në mënyrë progresive sa më shumë të jetë e mundur për angazhimin social të të moshuarve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:
- Salla, mjedisi të organizohet në mënyrë të tillë që të gjithë të kenë mundësinë të aktivizohen pa shqetësuar njëri-tjetrin.
 - Mundësimi i pjesëmarrjes së të gjithë të moshuarve.
 - Materiale, artikuj, lojra, libra revista, fjalëkryqe etj., për të mbështetur realizimin e modulit.
-

2. Moduli "Vlerësimi i gjendjes social-shëndetësore të të moshuarve në nevojë"

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	VLERËSIMI I GJENDJES SOCIAL - SHËNDETËSORE TË TË MOSHUARVE NË NEVOJË	M-21-1210-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë praktike për të vlerësuar gjendjen dhe nevojën shëndetësore të të moshuarit.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar 9 vjeçar.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi verifikon të dhënat mjekësore të pacientit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë verifikimin e diagnozës; - të kryejë verifikimin e mjekut të familjes; - të kryejë verifikimin e mjekut kurues; - të kryejë verifikimin e infermieres së shtëpisë; - të plotësojë me kujdes formularin përkatës. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi vlerëson të dhënat shëndetësore të pacientit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë vlerësimin e inkontinencës; - të kryejë vlerësimin e defekimit; - të kryejë vlerësimin e urinimit; - të kryejë vlerësimin e kateterit; - të kryejë vlerësimin e anuspraeterit; - të kryejë vlerësimin e reduktimit të orientimit; - të kryejë vlerësimin e dekubituesit; - të kryejë vlerësimin e kontrakturave; - të kryejë vlerësimin e trombozave; - të kryejë vlerësimin e vartësisë prej duhanit,alkoolit dhe drogës; - të plotësojë me kujdes formularin përkatës. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 3	Nxënësi vlerëson gjendjen emocionale dhe fizike të pacientit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë vlerësimin e aftësive komunikuese;
- të kryejë vlerësimin e qetësisë dhe gjumit;
- të kryejë vlerësimin e humorit të përgjithshëm;
- të kryejë vlerësimin e aftësive lëvizore;
- të kryejë vlerësimin e shkallës së përkujdesjes trupore;
- të kryejë vlerësimin e aftësisë për t'u ushqyer;
- të kryejë vlerësimin e aftësisë për t'u veshur/zhveshur;
- të plotësojë me kujdes formularin përkatës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të realizohet në spitale, shtëpi për të moshuar, shtëpi banimi për të vlerësuar realisht gjendjen shëndetësore të njerzve në nevojë. – Mësimdhënësi duhet demonstrojë me korrektësi dhe përkushtim vlerësimin e gjendjes shëndetësore. – Nxënësit duhet të angazhohen në mënyrë progresive sa më shumë të jetë e mundur në vlerësimin e gjendjes shëndetësore. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme: – Spitale, klinika ,shtëpi pleqsh etj. – Formularë të përgatitur përkatësisht për vlerësimin e nevojës shëndetësore. – Udhëzues, rregullore, katalogë etj.

3 Moduli “Zbatimi i masave parandaluese shëndetësore”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 11

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	ZBATIMI I MASAVE PARANDALUESE SHËNDETËSORE	M-21-251-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për zbatimin e masave për parandalimin infeksioneve, kontrakturave, dekubitusit, pneumonive dhe trombozave	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënitt (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi zbaton masat për parandalimin e infeksioneve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përgatisë vendin e punës; - të përzgjedhë drejt materialet dhe pajisjet e punës; - të dezinfektojë duart e tij para dhe pas çdo procesi pune; - të dezinfektojë mjetet dhe materialet ndihmëse duke zbatuar procedurat përkatëse; - të dezinfektojë mjedisi dhe pajisjet hidrosanitare duke zbatuar procedurat përkatëse; - të veshë dhe mbajë pastër uniformën e punës; - të zbatojë masat parandaluese për TBC duke zbatuar procedurat përkatëse; - të zbatojë masat parandaluese për Hepatit duke zbatuar procedurat përkatëse; - të zbatojë masat parandaluese për AIDS duke zbatuar procedurat përkatëse; - të bëjë trajtimin e kujdesshëm të materialeve septike dhe aseptike duke zbatuar procedurat përkatëse; - të kryejë punimin septik duke zbatuar procedurat përkatëse; - të bëjë trajtimin e veshjeve të pacientit dhe familjarëve sipas procedurës; - të bëjë trajtimin e mbeturinave pas punimit septik; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi zbaton masat për parandalimin e dekubitusit Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës
- të kryejë lehtësimin e zonave të shtypjes duke zbatuar procedurat përkatëse;
- të kryejë përmirësimin e gjendjes së përgjithëshme duke zbatuar procedurat përkatëse;
- të zbatojë masat higjienike personale dhe intime;
- të bëjë eliminimin e lagështirës;
- të stimulojë funksionin e qarkullimit të gjakut;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi zbaton masat për parandalimin e kontrakturave

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përgatisë veten dhe pacientin për procesin;
- të bëjë pozicionimin korrekt të të gjithë trupit të pacientit sipas procedurave përkatëse;
- të shmangë shtypjen e kontrakturave prej mbulesave;
- të kryejë saktë ushtrimet e hershme;
- të kryejë ushtrime lëvizore në të gjitha procedurat e përkujdesjes;
- të kryejë terapinë e lëvizjes së përcaktuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi zbaton masat për parandalimin e pneumonive

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përgatisë veten dhe pacientin për procesin;
- të bëjë pozicionimin korrekt të të gjithë trupit të pacientit sipas procedurave përkatëse;
- të kryejë veprimet e duhura për përmirësimin e ventilimit të mushkërive;
- të kryejë veprimet e duhura për parandalimin e grumbullimit të sekrecioneve;
- të kryejë veprimet e duhura për parandalimin e aspirimit/thithjes;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Nxënësi zbaton masat për parandalimin e trombozave

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përgatiasë veten dhe pacientin për procesin;
- të bëjë pozicionimin korrekt të të gjithë trupit të pacientit sipas procedurave përkatëse;
- të kryejë veprimet për stimulimin e qarkullimit të gjakut

- sipas procedurës përkatëse;
- të kryejë veprimet për komprimimin/shtrëngimin e venave sipas procedurave përkatëse.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të trajtohet në spitale, klinika, shtëpi për të moshuar. – Mësuesi duhet të demonstrojë saktë profilaksinë infeksioneve mikrobiale, dekubituesit, kontrakturave, pneumonive si dhe trombozave tek njeriu në nevojë. – Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete në të gjitha masat profilaktike të lartpërmendura. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të nxënësve.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi, njerëzit në nevojë, pajisjet dhe materialet si më poshtë: – Spitale, klinika, shtëpi për të moshuar etj – Materialet ndihmëse për përkujdesje dhe artikuj sanitarë – Udhëzuesa, katalogë, rregullore etj.

4. Moduli “Drejtues për një ditë”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	DREJTUES PËR NJË DITË	M-17-2198-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë praktike për të zhvilluar/identifikuar aftësitë për gatishmërinë në punë, kualifikimi profesional në grupit, kryerjen e vizitës në biznes, si dhe organizimin e veprimtarisë përmbyllëse të “Drejtues për një ditë”.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	

Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit

RN 1 Nxënësi zhvillon aftësi për gatishmërinë në punë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë aftësitë kryesore që duhet të zotërojnë një drejtues/ lider biznesi/ kompanie të suksesshëm;
- të analizojë aftësitë e përcaktuara për sukses në këndvështrimin vetjak;
- të identifikojë aftësitë vetjake për sukses, duke përdorur formularin e vetëvlerësimit;
- të identifikojë aftësitë personale që duhet t'i zhvillojë më tej;
- të identifikojë vendin e punës në përputhje me aftësitë vetjake për sukses;
- të vlerësojë aftësitë që lidhen me gatishmërinë për punë, si aftësi të përgjithshme për çdo vend pune;
- të përgatitë jetëshkrimin (*Curriculum Vitae* - CV), duke përfshirë aftësitë më të mira vetjake;
- të reflektojë rreth përmbatjes së CV, sipas kriterëve dhe formatit të dhënë;
- të demonstrojë aftësi të mira, gjatë kryerjes së një interviste nga një anëtar i grupit;
- të intervistojë një nga anëtarët e grupit, duke përdorur pyetje të gatshme ose të përgatitura vetë;
- të prezantojë veten dhe aftësitë vetjake nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit;
- të identifikojë elementët kryesorë që lidhen me një vend pune si: veshja, pritshmëritë për vendin e punës, përshendetjet dhe prezantimet;
- të përdor aftësitë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi zhvillon aftësitë e kualifikimit profesional të grupit.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të inkurajojë reagime, pyetje, pjesëmarrje nga grupi i punës;
- të përshtatë mënyrën e komunikimit, sipas situatës dhe audiencës (moshës, kulturës, rolit të personit të cilit i drejtohet etj.);
- të përdorë gjuhë verbale dhe jo verbale në mënyrë të përshtatshme;
- të përdorë gjuhë pozitive dhe motivuese;
- të jetë transparent dhe i hapur në informacion;
- të dëgjojë aktivisht pa ndërprerë bashkëbiseduesin;
- të organizojë grupin, duke krijuar frymë pozitive bashkëpunimi;
- të ndërtojë marrëdhënie të shëndetshme me anëtarët e grupit;
- të motivojë/frymëzojë grupin e punës, duke krijuar energji pozitive;
- të tregojë empati dhe respekt për ndjenjat dhe mendimet e të tjerëve;
- të ndërveprojë me të tjerët në mënyrë të përshtatshme për situatën;
- të zhvillojë vetëbesimin dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj komunitetit shkollor;
- të zgjidhë në kohë dhe në mënyrën e duhur dilema etike;
- të respektojë rregullat e sigurisë në punë dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë kualifikimit profesional të grupit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi parapërgatitet për kryerjen e vizitës në biznes.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë biznesin ku do të realizohet vizita "Drejtues për një ditë";
- të përzgjedhë sipërmarrësit e rinj të Junior Achievement (JA);
- të rekrutojë drejtuesit për një ditë, sipas kriterëve të përcaktuara;
- të hartojë një plan pune për vizitën në biznes;
- të dakordësojë me biznesit, datën e vizitës "Drejtues për një ditë";
- të planifikojë aktivitetet ditore;
- të menaxhojë burimet materiale;
- të komunikojë me grupin e punës;
- të përgatitë listën me kandidatët e mundshëm "Drejtues për një ditë";
- të përgatitë ftesën e takimit për drejtuesit e mundshëm;
- të përcaktojë kriteret për numrin e pjesëmarrësve "Drejtues për një ditë";
- të informojë grupin dhe drejtuesit për kryerjen e vizitës "Drejtues për një ditë";
- të përgatitë pyetjet intervistuese për drejtuesit e JA-së që do takojnë;
- të ushtrohet për t'iu përgjigjur pyetjeve, gjatë intervistës së drejtuar nga përfaqësuesi i biznesit;
- të ndajë detyrat për secilin anëtar të grupit;
- të informojë, në rrugë elektronike, planin e punës për vizitën në biznes;
- të respektojë rregullat e sigurisë në punë dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë parapërgatitjes për kryerjen e vizitës në biznes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen vizitën në biznes si "Drejtues për një ditë".

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të luajë rolin e një drejtuesi përmes vëzhgimit dhe/ose simulimit të kualifikimit profesional të një biznesi për një ditë;
- të njihet me vendin e punës dhe me mundësitë e vlefshme të karrierës së tyre;
- të demonstrojë lidhjen ndërmjet shkollës dhe karrierës;
- të ndjekë proceset e punës, gjatë vizitës në biznes;
- të vëzhgojë sjelljen dhe komunikimin në një ambient pune;
- të vlerësojë aftësitë kyçe të një drejtuesi (komunikimi, vendimmarrja, motivimi, planifikimi) gjatë vizitës;
- të plotësojë formularët që mbledhin informacion lidhur me:
 - misionin e veprimtarisë ekonomike të një biznesi;
 - vendin e punës dhe aftësitë e lidhura me të;
 - veprimaritë që kryhen, gjatë vizitës në biznes;
 - zbatimin e rregullave të komunikimit me etikë dhe

- profesionalizëm;
- intervistimin me pyetje të drejtuara nga nxënësi;
- intervistimin me pyetje të drejtuara nga përfaqësues të biznesit;
- përshtypjet pas veprimtarive të kryera;
- zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe të mbrojtjes në vendin e punës;
- të marrë vendim për situatat e paparashikuara;
- të reflektojë mbi përvojën vetjake si “Drejtues për një ditë”;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë vizitës në biznes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi organizon veprimtarinë përmbyllëse të “Drejtuesi për një ditë”.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin për realizimin e eventit përmbyllës;
- të sigurojë logjistikën e duhur për realizimin e eventit përmbyllës:
- të përpilojë listën e të ftuarve në eventin përmbyllës;
- të sigurohet për pjesëmarrjen e të ftuarve në event;
- të përcaktojë detyrat për realizimin e eventit përmbyllës;
- të informojë media të ndryshme lidhur me eventin përmbyllës;
- të përgatitë një fjalim për të ndarë përvojën emocionet, angazhimin, përgjegjësitë, gjatë përvojës si “Drejtues për një ditë”;
- të dokumentojë etapat e realizimit të vizitës në biznes (foto, video, raport informues);
- të ndajë certifikata pjesëmarrje për të gjithë anëtarët e grupit;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë eventit përmbyllës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në shkollë dhe në biznes.
- Mësimdhënësi duhet të kryejë demonstrime konkrete lidhur me hapat që ndiqen për të zhvilluar/ identifikuar aftësitë për gatishmërinë në punë, kualifikimit profesional të grupit, kryerjen e vizitës në biznes, si dhe organizimin e veprimtarisë përmbyllëse të “Drejtues për një ditë”.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë për të zhvilluar/ identifikuar aftësitë për gatishmërinë në punë, kualifikimi profesionaln e grupit, kryerjen e vizitës në biznes, si dhe organizimin e veprimtarisë përmbyllëse të “Drejtues për një ditë”.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet t’i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive dhe aftësive praktike për të

	zhvilluar/ identifikuar aftësitë për gatishmërinë në punë, kualifikimi profesionaln e grupit, kryerjen e vizitës në biznes, si dhe organizimin e veprimtarisë përmbyllëse të “Drejtues për një ditë”. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizmit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Udhëzuesi i mësuesit. – Udhëzuesi i nxënësit. – Formularë vetëvlerësimi. – Formular reflektimi. – Formularë raportimi. – Formular për planifikimin e ditës së kualifikimit profesional. – Fletë pune për pyetje intervistuese. – Materiale kancelarie. – Udhëzues për koordinatorin në terren. – Certifikatat e arritjeve. – Kompjuter/ Laptop. – Projektor. – Internet.

5 Moduli “Kryerja e gjimnastikës shëruese”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 11

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KRYERJA E GJIMNASTIKËS SHËRUESE	M-21-258-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer rivendosjen e funksioneve të aparatit të lëvizor dhe të sistemit vegjetativ nëpërmjet trajtimit pasiv dhe aktiv.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen procese përgatitore për fillimin e gjimnastikës shëruese. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përgatisë vendin dhe mjetet e punës; - të përzgjedhë materialet dhe barnat e duhura; - të përzgjedhë veshjen e përshtatshme; - të informojë me detaje individin në nevojë për procesin; - të përcaktojë llojin e aplikimit që do kryhet; - të pozicionojë të moshuarin në nevojë në përshtatje me procesin që do të kryhet; - të mundësojë krijimin e mjedisit të përshtatshëm; - të bëjë lehtësimin paraprak të dhimbjeve me akull ose barna; - të demonstrojë para të sëmurit lëvizjet aktive të procesit; - të zbatojë rregullat e etikës profesionale. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi kryen procesin e gjimnastikës shëruese. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë masazhimin e gjymtyrëve gjatë larjes; - të kryejë lëvizjet e plota të kyçeve gjatë larjes; - të kryejë lëvizjet e veçanta të gjymtyrëve gjatë përgatitjes së shtratit; - të kryejë lëvizjet aktive izometrike; - të kryejë lëvizjet aktive izotonike; - të kryejë lëvizjet ritmike mbledhje-shtrirje; - të kryejë lëvizjet për shkëmbimin aerobik të lëndëve; - të kryejë larjn dhe rehatimin e të moshuarit në nevojë; - të kontrollojë vazhdimisht gjendjen shpirtërore, pulsën dhe	

- frymëmarrjen e të moshuarit në nevojë;
- të zbatojë rregullat e etikës profesionale;
- të zbatojë me përpikmëri protokollin përkatës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të realizohet në kabinet kujdesi social-shëndetësor, spitale, shtëpi për të moshuar etj. – Mësimdhënësi duhet të kryejë demonstrime të sakta praktike për procesin e gjimnastikës shëruese. – Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për kryerjen e lëvizjeve të ndryshme dhe llojeve të gjimnastikës shëruese. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi të demonstrimi praktik i njohurive dhe aftësive të fituar.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, personat në nevojë social-shëndetësore, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Kabinet kujdesi social-shëndetësor, spital, shtëpi për të moshuar. – Mjetet ndihmese për të realizuar gjimastiken shëruese, artikuj sanitarë, kremra, pomada etj.

6. Moduli “Përkujdesja për të moshuarin gjatë dhe pas vdekjes”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA PËR TË MOSHUARIN GJATË DHE PAS VDEKJES	M-21-669-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë praktike për përkujdesjen e të moshuarit gjatë procesit të vdekjes dhe pas saj.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës së 11- të të kualifikimit profesional mësimor “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen përkujdesjen për të moshuarin gjatë vdekjes. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të respektojë të drejtat e të moshuarit gjatë vdekjes; - të analizojë problematikën e ndihmës gjatë vdekjes; - të kryejë komunikimin dhe interaksionin gjatë vdekjes; të ndërtojë marrëdhënie mirëkuptimi dhe besimi reciprok me të moshuarin; - të ndërtojë marrëdhënie mirëkuptimi dhe besimi reciprok me familjarët - të asistojë gjatë vdekjes sipas Kubler-Ross; - të kryejë përkujdesjen në simptomat fizike; - të kryejë ndihmën lehtësuese; - të respektojë ngarkesat psikologjike të personelit shëndetësor; - të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer; - të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me të moshuarin; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit. <i>Instrumentat e vlerësimit:</i> Vëzhgim me listë kontrolli. RN2 Nxënësi monitoron të moshuarin në çastet e fundit të jetës. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të identifikojë ndryshimin e shenjave jetësore të i moshuari në çastet e fundit të jetës; - të identifikojë shenjat e vdekjes të i moshuari; - të kryejë vlerësimin e shenjave të afrimit të vdekjes; - të kryejë veprimet pas përcaktimit të vdekjes;	

- të asistojë në procedurat e vërtetimit dhe dokumentimit të vdekjes;
- të kryejë përkujdesjenpërkujdesjen për të vdekurin sipas procedurave dhe riteve fetare përkatëse;
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me të moshuarin
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të realizohet në spitale, shtëpi për të moshuar, shtëpi banimi për përkujdesjen gjatë vdekjes dhe për të vdekurin.
- Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet demonstrojë me korrektësi dhe përkushtim për përkujdesjen gjatë vdekjes dhe për të vdekurin.
- Nxënësit duhet të angazhohen në mënyrë progresive sa më shumë të jetë e mundur për përkujdesjen gjatë vdekjes dhe për të vdekurin.
- Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet të përdorin metodën e simulimit për të realizuar situatat e ndryshme të shërbimit dhe të kujdesit për të moshuar që parashikohen në modulet e praktikës profesionale.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:
- Spitale, klinika, shtëpi të moshuarish, etj.
 - Manekinë dhe mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme
 - Formularë të përgatitur përkatësisht për përkujdesjen gjatë vdekjes dhe për të vdekurin.
 - Udhëzuesa, CD, rregullore, katalogë, fatura financiare etj.
-

7. Moduli “Shoqëria e nxënësve”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHOQËRIA E NXËNËSVE	M-17-2199-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të krijuar një shoqëri/ kompani biznesi, për të: kryer procedurat e zgjedhjeve për drejtues e personel, analizuar produktin, kryer proceset e shitjes dhe blerjes, për të promovuar produktin e shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi krijon shoqëri/ kompani. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë studimin fillestar të tregut për krijimin e një shoqërie/ kompanie; - të përcaktojë qartë qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë; - të përcaktojë qartë llojin e biznesit (tregti, prodhim, shërbim etj.), si dhe fushën ekonomike në të cilën do të zhvillohet veprimtaria; - të vendosë emrin e shoqërisë/ kompanisë, duke pasur parasysh veprimtarinë dhe qëllimin e saj; - të përcaktojë qartë misionin dhe vizionin në lidhje me veprimtarinë dhe identitetin e shoqërisë/ kompanisë; - të përzgjedhë formën juridike më të përshtatshme, në varësi të mundësive të financimit dhe kërkesave të pronarëve; - të hartojë dokumentet themelore juridik (statuti/ rregullore ose akt themelimi); - të regjistrojë shoqërinë/ kompaninë në Qendrën Kombëtare të Bizneseve (QKB); <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> - Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi kryen procedurat e zgjedhjeve për drejtues dhe personel.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të planifikojë një proces zgjedhor/ rekrutimi transparent (kandidatët, mënyrën e votimit, afatet, rregullat etj.);
- të ndjekë një rend dhe strukturë të caktuar në organizimin e votimeve (në asamblenë e aksionerëve);
- të hartojë një rregullore të qartë dhe të thjeshtë për funksionimin e departamenteve të shoqërisë/ kompanisë;
- të prezantojë rregullat për zgjedhjen në departamente;
- të prezantojë rolet që duhet të mbulojnë kandidatët e propozuar, sipas departamenteve;
- të respektojë mendimin e shumicës dhe kur ai nuk përputhet me preferencat personale;
- të zgjedhë personin e duhur për drejtues / personel, sipas aftësive për rolin;
- të vlerësojë cilësitë e liderit (motivimin, përgjegjshmërinë, korrektësinë, përkushtim etj.);
- të përdorë mënyra të ndryshme ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- të kontribuojë për një atmosferë bashkëpunuese, gjatë procesit zgjedhor;
- të pranojë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për drejtues dhe personel.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi analizon produktin e përzgjedhur objekt i veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë qëllimin kryesor dhe dytësorë të studimit të tregut;
- të përcaktojë objektivat e studimit të tregut;
- të përcaktojë metodën bazë për studimin e tregut;
- të krijojë grupin e punës për studimin e tregut dhe të ndajë detyrat në grup;
- të përzgjedhë metodat kryesore dhe burimet e mbledhjes së të dhënave (intervista, pyetësorë, hulumtim on-line etj.);
- të përgatitë pyetësorët për mbledhjen e të dhënave të tregut;
- të realizojë me kujdes dhe saktësi intervistimet në funksion të objektit të studimit të tregut;
- të kryejë përpunimin paraprak të të dhënave, duke i seleksionuar ato;
- të kryejë përpunimin statistikor dhe analizën përmbajtësore të të dhënave;
- të përgatitë rezultatet e studimit të tregut (gjetjet dhe propozimet);
- të hartojë planin e biznesit duke:
- prezantuar qartë idenë dhe përshkruar në mënyrë të detajuar sipërmarrjen;

- përshkruar qartë prodhimin/ tregtimin;
- përcaktuar karakteristikat që dallojnë ofertën e shoqërisë/ kompanisë së tij nga ajo e konkurrentëve;
- përcaktuar vendndodhjen, ku do të zhvillojë aktivitetin biznesi i saj;
- përcaktuar politikat që ndiqen për produktin apo shërbimin;
- pasqyruar tabelat për shpenzimet e parashikuara dhe të ardhurat e pritshme;
- përcaktuar burimet financiare që nevojiten për të kryer investimet fillestare;
- përshkruar se si do të organizohet biznesi, duke specifikuar numrin e të punësuarve, llojin e kontratave dhe kostot relative;
- të kontrollojë përfundimisht strukturën dhe korrektësinë e përmbajtjes së planit të biznesit;
- të vlerësojë cilësinë, dobishmërinë dhe përputhjen e produktit me nevojat e tregut;
- të vlerësojë përfitimet dhe kufizimet e produktit;
- të vlerësojë mendimet e përdoruesve/ testuesve të produkteve;
- të përmirësojë vazhdimisht produktin, sipas analizimeve të bëra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen proceset e blerjes/ shitjes.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë nevojat për blerje për fillimin e aktivitetit;
- të evidentojë furnitorët potencialë në fushën e biznesit;
- të analizojë furnitorët ekzistues;
- të kontaktojë furnitorët potencialë dhe të sigurojë informacione për ta;
- të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal, gjatë komunikimit me furnitorët;
- të kërkojë oferta e lista çmimesh për artikuj;
- të krahasojë ofertat e furnitorëve potencialë dhe të evidentojë ofertën më të përshtatshme për biznesin;
- të hartojë planin e blerjes dhe të ndjekë realizimin e tij;
- të ndjekë hapat e duhura, gjatë procesit të blerjes;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm që përdoret, gjatë procesit të blerjes;
- të kërkojë me kujdes informacione për klientët potencialë;
- të përpunojë kërkesat e klientëve;
- të hartojë listat e çmimeve për klientët;
- të hartojë oferta të ndryshme;
- të pranojë, kontrollojë dhe regjistrojë saktë, porositë e mbërritura nga klientët;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm, gjatë procesit të shitjes;
- të kryejë kontrollin e gjendjes fizike të produkteve për shitje;
- të përgatitë produktin për shpërndarje;

- të ambalazhojë produktin, sipas rastit;
- të përzgjedhë kushtet e lëvrimit dhe pagesës që i përshtaten më mirë shoqërisë/ kompanisë, qëllimeve dhe kushteve të veprimtarisë së saj;
- të hartojë saktë faturat e shitjes së mallrave;
- të hartojë refuzimet e shitjeve për arsye dhe në situata të ndryshme;
- të zgjidhë situatat në raste ankesash nga klientët;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë blerjes/ shitjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë produktin të cilit do t'i bëhet marketingu;
- të identifikojë lloje të ndryshme të platformave digjitale dhe mediave sociale;
- të analizojë kriteret për përzgjedhjen e platformës digjitale dhe medias sociale;
- të përzgjedhë platformën digjitale dhe median sociale;
- të prezantojë platformën digjitale dhe median sociale të përzgjedhur;
- të përgatitë materiale të ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj.);
- të hartojë fletëpalosje dhe materiale të tjera reklamuese dhe informuese;
- të hartojë kartëvizitat e materiale të tjera informative për shoqërinë/ kompaninë dhe personelin e saj;
- të ndërtojë video, duke përdorur programe (softëare) të ndryshme (Movie maker ose nëpërmjet aparatit celular, smartphone etj.);
- të modifikojë imazhe të ndryshme me softëare (photoshop, canva etj.);
- të ngarkojë (publikojë) materialet e mësipërme në platformën digjitale dhe median sociale të përzgjedhur;
- të përgatitë një plan orar, ditor dhe javor në lidhje me promovimin e produkteve të shoqërisë/ kompanisë;
- të krijojë fushata marketingu, duke përdorur burime të ndryshme reklamimi (rrjetet sociale, e-mail ose mobile marketing);
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm, gjatë promovimit të produktit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi harton dhe analizon raportin vjetor.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë një pasqyrë të thjeshtë financiare të mjeteve,

- detyrimeve dhe kapitalit të vetë shoqërisë/ kompanisë;
- të evidentojë saktë se cilët dokumente do të përdoren për regjistrimin dhe pasqyrimin e veprimtarisë;
- të hartojë saktë dokumentet që mund të përdoren në shoqëri/ kompani (ditarin, librin e arkës, libër i magazinës etj.);
- të regjistrojë gjendjen në dokumentet financiare përkatës;
- të regjistrojë saktë derdhjet e aksionerëve në para dhe në natyrë, sipas llojeve;
- të regjistrojë saktë derdhjet e kapitalit të nënshkruar në fillim dhe gjatë veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë;
- të regjistrojë saktë shumat e shpenzimeve të paguara paraprakisht për krijimin, regjistrimin, asistencën ligjore, si dhe për zgjerimin e veprimtarisë ose ndryshimin e formës juridike;
- të regjistrojë blerjet dhe shitjet e kryera;
- të regjistrojë saktë shpenzimet e punës, detyrimet ndaj personelit, sigurimeve dhe shtetit për TAP, duke u bazuar në listëpagesën e pagave;
- të deklarojë në afatin e duhur detyrimet ndaj shtetit;
- të kryejë saktë mbylljen e llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve;
- të evidentojë rezultatin ekonomik të shoqërisë/ kompanisë;
- të prezantojë rezultatin përfundimtar të shoqërisë/ kompanisë;
- të marrë vendim për shpërndarjen e dividendit, bazuar në përqindjen të aksioneve;
- të kryejë veprimet për likuidimin përfundimtar të shoqërisë/ kompanisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në shkollë/ klasë dhe në biznes.
- Mësimdhënësi duhet të kryejë demonstrime konkrete lidhur me hapat që ndiqen për: krijimin e një shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë lidhur me krijimin e një shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe të blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjes së raportit përfundimtar.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për krijimin e një shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe të blerjes, promovimin e produktit të

	shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjes së raportit përfundimtar. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizmit të specifikuara për çdo rezultat të nxënësit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Udhëzuesi i mësuesit. - Udhëzuesi i nxënësit. - Model statuti dhe akt themelimi. - Modele pasqyrash financiare. - Model letra me vlerë/ aksione. - Libër i arkës. - Libër/ kartela magazine. - Model pyetësori. - Formularë të porosive të shitjeve. - Formularë raportimi. - Materiale kancelarie. - Certifikatat e arritjeve. - Kompjuter/ Laptop. - Projektor. - Internet. - USB dhe CD.

8. Moduli “Përkujdesja për dhimbjet dhe sëmundjet tumorale të të moshuarit”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJA PËR DHIMBJET DHE SËMUNDJET TUMORALE TE TË MOSHUARIT	M-21-668-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë praktike për përkujdesjen për dhimbjet dhe sëmundjet tumorale.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës së 11- të të kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen vlerësimin e treguesve shëndetësorë të pacientit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë vrojtimin e të sëmurit; - të kryejë vlerësimin e dhimbjeve dhe domethënies së tyre duke zbatuar kriteret; - të kryejë vlerësimin e dhimbjeve në raste paaftësish të lindura; - të përcaktojë trajtimet jomedikamentozë për lehtësimin e dhimbjes duke patur parasysh veçantinë e trajtimit të dhimbjes tek të moshuarit; - të përcaktojë trajtimet medikamentozë për lehtësimin e dhimbjes duke patur parasysh veçantinë e trajtimit të dhimbjes tek të moshuarit. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. RN 2 Nxënësi kryen përkujdesjen për qetësimin e dhimbjeve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë trajtimin jomedikamentoz për lehtësim të dhimbjes; - të kryejë trajtimin medikamentoz për lehtësimin e dhimbjes; - të kryejë sipas manualit përkujdesjen në nazet dhe të vjella; - të kryejë sipas manualit përkujdesjen në raste lodhjeje dhe pafuqie; - të kryejë sipas manualit përkujdesjen në ulçerat tumorale;	

- të kryejë sipas manualit përkujdesjen gjate trajtimit me rrezatim;
- të kryejë sipas manualit përkujdesjen gjate terapise zitostatike;
- të kryejë sipas manualit përkujdesjen paliative;
- të plotësojë saktë faturat financiare për shërbimin e kryer;
- të komunikojë drejt dhe me etikë profesionale me të moshuarin;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve	– Ky modul duhet të realizohet në spitale onkologjike, shtëpi për të moshuar, shtëpi banimi për përkujdesjen për dhimbjet dhe sëmundjet tumorale; – Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet demonstrojë me korrektësi dhe përkushtim për përkujdesjen për dhimbjet dhe sëmundjet tumorale. – Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet të përdorin metodën e simulimit për të realizuar situatat e ndryshme të shërbimit dhe të kujdesit për të moshuar që parashikohen në modulet e praktikës profesionale. – Nxënësit duhet të angazhohen në mënyrë progresive sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari praktike për përkujdesjen ndaj të moshuarve për dhimbjet dhe sëmundjet tumorale. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme: – Spitale onkologjike, klinika shtëpi pleqsh etj. – Formularë të përgatitur përkatësisht për përkujdesjen për dhimbjet dhe sëmundjet tumorale. – Manekinë dhe mjete të tjera për të realizuar simulimin e situatave të ndryshme. – Udhëzues,CD, rregullore, manualë, fatura financiare etj.

9.Moduli “Mbrotjtja e të drejtave të të moshuarve, shmangia e abuzimeve dhe procesi i ankimimit”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MBROJTJA E TË DREJTAVE TË TË MOSHUARVE, SHMANGIA E ABUZIMEVE DHE PROCESI I ANKIMIMIT	M-20-670-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë praktike për mbrojtjen e të drejtave të të moshuarve, shmangien e abuzimeve ndaj tyre, si dhe procesin e ankimimit që ata mund të kryejnë.	
Kohëzgjatja e modulit	64 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, në kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi mbron të drejtat e të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të mundësojë pjesëmarrjen në procesin politik dhe në votime sipas dëshirës së të moshuarit; - të mbrojë të moshuarin ndaj fyerjeve dhe sharjeve; - të mbrojë të drejtat financiare të të moshuarit; - të mbrojë të drejtat psikologjike të të moshuarit; - të mbrojë të drejtat fizike të të moshuarit; - të mbrojë të drejtat seksuale të të moshuarit; - të mbrojë të moshuarin nga diskriminimi; - të mbrojë të moshuarin nga plagosja e vetes; - të raportojë rastet e abuzimit të të moshuarit. Instrumentat e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli
	RN 2	Nxënësi shmang abuzimet ndaj të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë : - të shmangë abuzimin fizik të të moshuarit si goditje, mbytje, helmime, etj; - të shmangë krijimin e sëmundjeve ose simptomave të qëllimshme të të moshuarit; - të shmangë keqtrajtimin emocional të të moshuarit; - të shmangë prezencën e të moshuarit në skena ose histori keqtrajtimesh;

- të shmangë detyrimin ose joshjen e të moshuarit për të marrë pjesë në veprimtari seksuale;
- të shmangë përdhunimin, homoseksualitetin të të moshuarit;
- të shmangë neglizhimin e të moshuarit, për të përmbushur nevojat fizike dhe psikologjike të tij;
- të shmangë neglizhimin e të moshuarit, për të siguruar një kujdes dhe trajtim të përshtatshëm mjekësor për të.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen procesin e ankimit për të moshuarin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë drejt formularët standard të ankimit;
- të mbajë sa më shpejt shënime për të gjitha ankesat, pretendimet ose deklaratimet e të moshuarit;
- të sqarojë rëndësinë e ankimit të të moshuarit;
- të mbajë me përpikmëri dhe hollësi procesverbalet e ankimit;
- të diferencojë vërtetësinë e thënieve të deklaruara nga i moshuari;
- të dallojë qartë kallëzimin, spekulimin, interpretimin e thënieve të të moshuarit;
- të trajtojë në mënyrë kofidenciale të gjithë procesverbalet;
- të ruajë kofidencialitetin e informacionit;
- të raportojë shqetësimet e ngritura në informacion në organet kompetente;
- të veprojë me urgjencë, nëse është e domosdoshme, përpara procedurës kallëzuese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të realizohet në spitale, shtëpi për të moshuar, shtëpi banimi për përkujdesjen e të moshuarve, etj.
- Mësimdhënësi dhe personeli shëndetësor duhet të demonstrojë me korrektësi e përkushtim mbrojtjen e të drejtave, shmangien e abuzimeve dhe procesin e ankimit të të moshuarve.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur për mbrojtjen e të drejtave të të moshuarve, shmangien e abuzimeve kundrejt tyre dhe procesin e ankimit që mund të bëjnë ata.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:

- Spitale, klinika ,shtëpi të moshuarish, etj.
- Formularë standard të ankimit, udhëzues, rregullore, etj.

10. Moduli “Rekrutimi i stafit dhe menaxhimi i burimeve njerëzore”

Kualifikimi profesional: Shërbime kujdesi për të moshuar

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	REKRUTIMI I STAFIT DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	M-17-829-25
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson nxënësit për të kryer procedurat e rekrutimit të stafit, organizimin e vogël të punës si edhe menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të cilësisë.	
Kohëzgjatja e modulit	64 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet praktike të klasës së 12 në kualifikimin profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”.	
Rezultatet e të nxënit (RN), procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen procedurat e rekrutimit të stafit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të shpallë publikisht njoftimin për vendet bosh sipas procedurave përkatëse; - të pranojë kërkesat e detajuara për kandidatin dhe pozicionin vakant të punës; - të kryejë grumbullimin dhe shqyrtimin e aplikimeve; - të kryejë përzgjedhjen fillestare të kandidatëve bazuar në aplikimet e mbërritura; - të njoftojë kandidatët e përzgjedhur për fazën e parë të intervistimit; - të marrë pjesë në zhvillimin e intervistave; - të marrë pjesë në kryerjen e testeve të ndryshme logjike dhe profesionale; - të përzgjedhë kandidatët fitues nga faza I e intervistimit; - të zhvillojë fazën e dytë të intervistimit me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të bordit drejtues të biznesit; - të përzgjedhë kandidatin fitues në përputhje me përshkrimin e vendit të punës. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. - Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës. - Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër. RN 2 Nxënësi menaxhon burimet njerëzore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:	

- të mirëmbajë aparaturat dhe teknikën e qendrës së shërbimit social – shëndetësor;
- të kryejë administrimin e shërbimeve sipas organigramës së personelit;
- të vlerësojë gjendjen higjieno - sanitare të mjediseve të qendrës, dhomave, tualeteve, oborrit, kopshtit etj.;
- të kryejë shërbimin e hotelerisë për sigurimin e ushqyerjes, fjetjes dhe rregullimit të dhomave;
- të kryejë shërbimin e lavanterisë dhe mirëmbajtjes së veshjeve, mbulesave, perdeve, teshave etj.;
- të kryejë shërbimin e transportit për klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i azilit.
- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër.

RN 3 Nxënësi bën organizimin e vogël të punës në qendër.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë hartimin dhe afishimin e organigramës;
- të kryejë hartimin dhe afishimin e planit të shërbimit në përputhje me kodin e punës;
- të caktojë personin përgjegjës për kontrollin e cilësisë së shërbimeve;
- të caktojë personin përgjegjës për sigurimin e ushqyerjes;
- të caktojë personin përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e higjienës;
- të caktojë personin përgjegjës për manipulimet specifike mjekësore;
- të caktojë personin përgjegjës për administrimin e produkteve farmaceutike;
- të përzgjedhë drejtuesin e personelit të shërbimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës.
- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër.

RN 4 Nxënësi menaxhon sigurimin e cilësisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbështesë zhvillimin e komunikimit të brendshëm;
- të mbështesë zbatimin e strukturës komunikative dhe procesin e reflektimit në funksion të organizimit ;
- të ndihmojë në realizimin e takimeve periodike;
- të ndihmojë në realizimin e takimeve periodike të stafit drejtues;
- të mbështesë formimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personave përgjegjës;
- të ndjekë takimet profesionale sipas sektoreve dhe përgjegjësi përkatese;

- të bëjë përshtatjen dhe modifikimin e përkujdesje për qendra rezidenciale, ditore si dhe direkt në familje;
- të bëjë zbatimin e vazhdueshëm të procesit të raportimit;
- të mbështetë përpunimin dhe përmirësimin e standardeve dhe udhëzimeve aktuale;
- të marrë pjesë në hartimin e pyetësorëve për vizitorët dhe familjarët;
- të kryejë administrimin e ankesave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës.
- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në një biznes social-shëndetësor, qendër ditore ose rezidenciale të cilat ofrojnë shërbime social-shëndetësore, shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore komunitare, etj.
- Mësuesi duhet të përzgjedhë me kujdes dhe të vendosë kontakte me institucione të ndryshme që ofrojnë këto shërbime.
- Mësuesi duhet të përpilojë listën e nxënësve që do vizitojnë institucionet dhe të shoqërojë secilin grup në prezantimin e parë.
- Mësuesi duhet të bëjë vizita sa më të shpeshta në qendra dhe të këtë kontakte të vazhdueshme për procesin.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen kontaktet me bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore ditore, rezidenciale, komunitare si dhe direkt në familje për njerëzit në nevojë.
 - Të sigurohet një marrëveshje tip midis shkollës dhe këtyrinstitucioneve
 - Këshillohet që orët e praktikës profesionale të realizohen konkretisht në bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetësore ditore, rezidenciale, komunitare sidhe direkt në familje për njerëzit në nevojë ku do të ndiqen nga mësuesi në bashkëpunim me referentin/presoni i kontaktit në qendër.
 - Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë etj.
 - Dokumentacioni përkatës i qendrës
 - Udhëzuesa, katalogë, rregullore etj.
-

Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Në përfundim të nivelit të IV KSHKsë në kualifikimin profesional “**Shërbime kujdesi për të moshuar**”, nxënësit i nënshtrohen Provimit Përfundimtar të praktikës profesionale të integruar, në zbatim të udhëzimit nr. 15, datë 26.04.2020 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në Arsimin dhe Formimin Profesional”.

Programi orientues për provimet përfundimtare të praktikës profesionale, në kualifikimin profesional ” **Shërbime kujdesi për të moshuar**”, Niveli IV KSHKsë me strukturë 4 vite mësimore, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë drejtim mësimor, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasat(10, 11, 12-të dhe 13-të), që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësuesit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në shkollat e larta apo në arsimin pas të mesëm.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësuesit/instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, detyrat e punës dhe pikët për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Të realizojë dhënien e ndihmës së parë në çrregullimet e frymëmarrjes dhe sëmundjet kardiovaskulare	Detyra 1: Dhënia e ndihmës së parë në rastet e mungesës së frymëmarrjes, në infarkt miokardi dhe ndihma e parë në rrëzime për shkak të sinkopit.	20
2	Të realizojë përkujdesjen trupore dhe ushqyerjen tek të moshuarit.	Detyra 2: Përkujdesja trupore dhe ushqyerja në përputhje me nevojat specifike të të moshuarit.	20
3	Të realizojë matjen e	Detyra 3: Matja e shenjave jetësore (puls,	10

	shenjave jetësore dhe të dokumentojë vlerat e matura.	presion arterial,temperaturë), shënimi i vlerave të matura në formularin përkatës.	
4	Të realizojë përkujdesjen në çrregullimet dhe sëmundjet e aparatit muskuloskeletik tek të moshuarit.	Detyra 4: Përkujdesja gjatë lëvizjes së të moshuarit me çrregullime dhe sëmundje të aparatit muskuloskeletik (përdorimi i bastunit,patericave,karroces me rrota etj).	10
5	Të realizojë përkujdesjen në çrregullimet dhe sëmundjet e dëgjimit, shikimit, parkinsonit dhe sklerozës	Detyra 5: Shoqërimi i të moshuarit me reduktim të dëgjimit ose/dhe shikimit, si dhe përkujdesja në sëmundjet e parkinsonit dhe sklerozës (me simulim).	20
6	Të realizojë hapjen dhe mbylljen e një biznesi në shërbim kujdesi për të moshuar.	Detyra 6: Prezantimi i dosjes së biznesit (procedurat për hapjen dhe mbylljen e biznesit, menaxhimi i përkujdesjes shëndetësore, procedurat për rekrutimin e stafit, mirëmbajtja e qendrës dhe menaxhimi i burimeve njerëzore).	20
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 – 40	4
41 – 50	5
51 – 60	6
61 – 70	7
71 – 80	8
81 – 90	9
91 – 100	10

Shënime:

- Provimi i praktikës profesionale do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “poste pune”, në grupe pune ose në mënyrë individuale, me 6 detyra praktike, në mjedise të simuluar në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor. Nxënësit do të vlerësohen për të paktën një ose dy prej detyrave të mësipërme, për shkak të kohës të përcaktuar të provimit.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin nr. 15. Datë 26.04.2019 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në arsimin dhe formimin profesional”, në fuqi.

- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërisht të përfshira në vlerësim.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t'i lihet hapësirë për vlerësim dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë paraprakisht pyetjet për bashkëbisedimin profesional.
- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit duke u testuar/vlerësuar në një nga detyrat, kjo edhe për shkak të kohës së kufizuar 3 orë të provimit praktik.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kriteret për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për çdo detyrë.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.

Detyra 1 do të realizohet në mjedise **të simuluar** në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor. Mjetet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e kësaj detyre janë: mjete ndihmëse, orë dore, kutia e ndihmës së shpejtë, aparat për matjen e tensionit arterial, termometër, medikamentet e urgjencës për të parandaluar infarktin, shtrat mjekësor etj. Nxënësit do të përdorin lojën me role, ku një nxënës i instruktuar më parë merr rolin e të dëmtuarit ndërsa nxënësi tjetër i jep ndihmën e parë. Nxënësi duhet të japë ndihmën e parë sipas protokolleve dhe metodave të përcaktuara dhe të dokumentojë të dhëna të thjeshta në vendngjarje.

Detyra 2 do të realizohet në mjedise **të simuluar** në kabinetin social-shëndetësor. Mjetet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e kësaj detyre janë: shtrat përkuqdesje, veshje, çarçaf, jastëk, pampers, ujë, detergjent, legenë, lavaman shtrati, peshqir, doreza, lavaman, karrocë me rrota, uturak, paterica, komplet pjatash, tasa, gota, lugë, pirunë, thika, pipa, peceta, peshqirë, tavolinë, solucion larës, pajisjet dhe artikujt sanitarë të nevojshëm për zhveshjen, larjen, dhe veshjen e individit në nevojë social-shëndetësore etj. Detyra do të realizohet në shtratin e përkuqdesjes ku qëndron i shtrirë pacienti (një nxënës i instruktuar më parë). Nxënësi do të realizojë përkuqdesjen trupore (larjen e kokës, trungut, gjymtyrëve, ndërrimin e pampersit, ndërrimin e çarçafëve etj.) si dhe pastrimin e duarve, largimin e mbetjeve dhe

materialeve të përdorura, transportimin e pacientit nga shtrati në karrocë e nga karroca në shtrat si dhe ushqyerjen e pacientit.

Gjatë realizimit të kësaj detyre nxënësi duhet të komunikojë vazhdimisht me individin në nevojë, për ta informuar mbi procedurën që do të kryej.

Detyra 3 do të realizohet në mjedise të simuluar në kabinetin e shërbimit social-shëndetësor.

Mjetet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e kësaj detyre janë: formular evidentimi, sfigmomanometër, orë dore ose kronometër, etj.

Nxënësit do të vlerësohen, gjatë realizimit të kësaj detyre, nëpërmjet lojës me role, ku një nxënës i instruktuar më parë merr rolin e individit në nevojë, ndërsa nxënësi tjetër mat shenjat vitale dhe harton planin e përkujdesjes në bazë të gjëndjes së pacientit.

Gjatë realizimit të kësaj detyre nxënësi duhet të komunikojë vazhdimisht me individin në nevojë, për ta informuar mbi procedurën që do të kryej.

Detyra 4 do të realizohet në mjedise të simuluar në kabinetin e shërbimit social-shëndetësor, në formën e bashkëbisedimit (lojës me role) ndërmjet punonjësit të kujdesit Social-Shëndetësor dhe pacientit. Mjetet e nevojshme për realizimin e kësaj detyre: karrocë me rrota, paterica, mbajtëse mbështetëse për pacientin, etj.

Nxënësit do të përdorin lojën me role, ku një nxënës i instruktuar më parë merr rolin e të dëmtuarit ndërsa nxënësi tjetër e ndihmon në lëvizje duke përdorur karrocën me rrota, patericat, mbështetëset, etj.

Detyra 5 do të realizohet në mjedise të simuluar në kabinetin e kujdesit social-shëndetësor, në formën e bashkëbisedimit (lojës me role) ndërmjet punonjësit të kujdesit Social-Shëndetësor dhe pacientit.

Nxënësit do të përdorin lojën me role, ku një nxënës i instruktuar më parë merr rolin e të dëmtuarit ndërsa nxënësi tjetër kryen përkujdesjen.

Nxënësi duhet të kryej përkujdesjen sipas protokolleve dhe metodave të përcaktuara.

Detyra 6 do të realizohet në formën e bashkëbisedimit mes komisionit të vlerësimit dhe nxënësit. Ata do të prezantojnë dosjen që përmban procedurat për hapjen dhe mbylljen e biznesit (qendër për të moshuar ditore ose rezidenciale), procedurat për rekrutimin e stafit, mirëmbajtjen e qendrës, marketingun e qendrës etj.

Secili nga postet e punës së lartpërmendur të ketë listë vlerësimi më vehte dhe në fund të realizimit të detyrave të parashikuara, të bëhet tabela përmbledhëse e pikëve dhe të hidhet nota përkatëse.

Nxënësit do të vlerësohen për realizimin e detyrave sipas listës përfundimtare të kontrollit.